



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Dega: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

Studimet Master

Punim masteri

Figuracioni në poezinë e Ndre Mjedjes

Mentorja:

Doc. dr. Meral Shehabi-Veseli

Kandidatja:

Syzane Shaqiri

Tetovë, 2021

Falënderim

Falënderoj dhe i jam mirënjohëse mentores Prof. Meral Shehabi-Veseli, për motivimin, përkrahjen dhe kontributin për realizimin e këtij punimi.

Gjithashtu falënderoj familjen time për përkrahjen, mirëkuptimin dhe inspirimin e dhënë nga ana e tyre.

Përmbajtja

Abstrakt	5
Abstract	6
Анстракт	7
Hyrje	8
Qëllimet e hulumtimit.....	9
Rëndësia e punimit	10
Metodat e hulumtimit	10
Struktura e punimit.....	11
KAPITULLI I	13
1.1. Ndre Mjeda, intelektual i që ia kushtoi jetën Shqipërisë	13
1.2. Romantizmi si drejtim dhe metodë letrare krijuese.....	14
1.3. Veprat e Ndre Mjedjes si krijime poetike	17
1.4. Objekti i studimit.....	22
KAPITULLI II	26
2.1. Semantika e poezisë së Mjedjes	26
2.2. Poemthi Vaji i bylbylit dhe rrethanat shoqërore	27
2.3. Largimi dhe vetmia në poemthin I tretuni.....	30
2.4. Jeta reale në poemën Andrra e jetës.....	34
2.5. Poezia atdhetare e Mjedjes	39
2.6. Figura e bilbilit në poemthin e Mjedjes	40
2.7. Njeriu i humbur dhe figuracioni poetik	41
2.8. Figuracioni në poemën Andrra e jetës.....	43
2.9. Hiperbola në poezinë e Mjedjes	45
KAPITULLI III	47
Historiku i sonetit shqip	47
3.1. Soneti Lirija sonet i lirisë së atdheut	48
3.2. Udhëtimi në kohë në poemën sonetike Lissus	53
3.3. Poema sonetike Scodra poemë mitike dhe historike	62
3.4. Poema sonetike Lirija thirrje për lirinë e atdheut.....	67

3.5. Figura e hiperbolës në poemën sonetike Lissus	69
3.6. Qyteti i Shkodrës si toponim dhe figurë në poemën Scodra	70
Përfundim	73
Bibliografia.....	74

Figuracioni në poezinë e Ndre Mjedjes

Abstrakt

Studimi i poezisë së Mjedjes do të bëhet sipas kësaj skeme: hulumtimi, grumbullimi dhe shfrytëzimi i literaturës, vlerësimi kritik i literaturës dhe sistemimi i saj. Për të arritur në analizën e thellë të poezisë së Ndre Mjedjes, paraprakisht nevojitet hulumtimi i literaturës teorike rreth parimeve të formacionit të romantizmit, llojet e rimës, veçoritë e poetikës, pikëpamjet për poezinë, pikëpamjet për gjuhën, pranimin dhe vlerësimin të saj.

Qëllimi i temës për poezinë e Mjedjes ka të bëjë me zbulimin e vlerave të mirëfillta të letërsisë shqipe, pa marrë parasysh që ato janë krijuar në një periudhë, ku Mjeda shfaqet në kulmin e romantizmit dhe u ndal në kohën e zhvillimit të letërsisë moderne. Me temat dhe idetë letrare ai hyn në rendin e Rilindësve shqiptarë, kurse me format bëhet poeti i paramodernitetit shqiptar.

Në këtë punim do të trajtohen disa aspekte të poezisë së Mjedjes, si në aspektin semantik po ashtu dhe në atë semiotik. Ky punim me këtë temë mbi poezinë e Mjedjes, me këtë skemë të paraqitur do të japë disa rezultate mbi studimin e poezisë së Mjedjes, duke mos përjashtuar as mendimet e studiuesve shqiptarë rreth poezisë së Mjedjes.

Fjalët kyçe: *Romantizëm, poezi, letërsi, Mjeda, figuracion.*

The figuration in Ndre Mjedje`s poetry

Abstract

The study of Mjedje's poetry will be done according to this scheme: research, collection and use of literature, critical evaluation of literature and its systematization. In order to arrive at an in-depth analysis of Ndre Mjedja's poetry, it is necessary to research the theoretical literature in advance about the principles of Romantic formation, types of rhyme, features of poetics, views on poetry, views on language, its acceptance and evaluation, figuration.

The aim of the topic of Mjedja's poetry is to discover the true values of Albanian literature, regardless of the fact that they were created in a period when Mjeda appears at the peak of Romanticism and stopped at the time of the development of modern literature. With literary themes and ideas he enters the order of the Albanian Renaissance, while with the forms he becomes the poet of the Albanian paramodernity.

In this paper, some aspects of Mjedje's poetry will be treated, both in the semantic aspect and in the semiotic aspect, where in this paper the following Mjedje's poetry will be studied.

This paper on this topic on Mjedja's poetry, with this presented scheme will give some results on the study of Mjedje's poetry, not excluding the opinions of Albanian scholars about Mjedja's poetry.

Keywords: *Romanticism, poetry, literature, Mjeda, figuration.*

Фигурацијата во поезијата на Ндре Мједа

Апстракт

Студијата за поезиите на авторот Мједа ќе се реализира на следниот начин: истражување, собирање и употребување на соодветната литература истотака и распределување на истата. За да дојдеме до длабоката анализа на поезиите на Ндре Мједа, потребно е да се истражува теориската литература за принципите и градбата на поезијата во периодот на романтизмот, римата, различностите на поетиката, поглед за поезијата, јазикот и вреднувањето на поезиите.

Целта на темата за поезиите на Мједа е пронаоѓањето на вредностите на таа поезија во албанската книжевност, без разлика дека тие се формирани во периодот кога Мједа е во врвот на романтизмот и заврши во периодот на модерното. Со темите и со книжевните идеи авторот се нареди меѓу редот на писателите на преродбата, додека со градбата на поезијата тој е автор на предмодернизмот во книжевноста.

Во ова истражување ќе се анализираат неколку аспекти на поезијата на Мједа, како во семантички така и во семиотички аспект. Ова истражување за поезиите на Мједа, со оваа схема ќе дава резултати за анализата на поезиите на Мједа, но и тврдењата ина другите албански истражувачи кои напишале студии за творештвото на Мједа.

Клучни зборови: *романтизам, поезија, Мједа, Книжевност, фигуративност.*

Hyrje

Romantizmi në letërsinë shqipe, ose romantizmi shqiptar është periudha në pikëpamje stilistike, më homogjene e letërsisë shqipe. Në qoftë se deri në shekullin XIX, letërsia popullore është krijimtaria qendrore shpirtërore në jetën e shqiptarëve, në periudhën e romantizmit letërsia e kufizuar nis të bëhet dhe dikur nga fundi i shekullit, edhe bëhet aktiviteti qendror mendor i kombit.

Krijimtaria gjuhësore artistike në këtë kohë, në shumicën e rasteve është krijimtari, që sintetizon veçoritë e fushave të ndryshme të krijimtarisë shpirtërore dhe është një krijimtari e tillë sintetizuese, sepse në jetën historike të kombit ende nuk janë diferencuar plotësisht as sferat e jetës kulturore, as institucionet politike, shoqërore dhe kulturore. Periudha historike në të cilën e shënon letërsia e romantizmit, që në historinë politike, të popullit shqiptar quhet Rilindja Kombëtare, është periudhë e një jete të jashtëzakonisht të vrulltë kombëtare politike, kulturore dhe letrare. Në këtë kohë të madhe janë bërë ndryshime të mëdha në jetën historike, prandaj edhe në jetën shpirtërore të shqiptarëve. Romantizmi është letërsi e këtyre ndryshimeve: ai i nxit dhe i dëshmon ato.¹

Letërsia e romantizmit shqiptar, ka përmbajtjen e Atdheut, por është krijuar dhe publikuar nëpër vende të huaja, para se gjithash, nëpër kolonitë shqiptare. *Ndre Mjeda është njëri prej poetëve të romantizmit shqiptar, që ka lënë pak poezi dhe poema. Për të gjallë ka botuar përmbledhjen e poezive e të poemave me titullin Juvenilia (1917), poemën tingëllimore Lissus (1921) dhe poemën tjetër tingëllimore Lirija (1937), kurse të botuara nëpër revista e gazeta, apo në dorëshkrim ka lënë edhe disa poezi të tjera, që nuk shquhen me vlerën artistike të tyre.²*

Poemat e Ndre Mjedjes ndryshojnë shumë prej poemave të tjera të romantizmit tonë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga ndërtimi kompozicional. Kur më pak e kur më shumë, ato ndryshojnë edhe njëra prej tjetrës: poemat që shkroi dhe që do të shkruan më vonë, sidomos në fund të krijimtarisë. Ndërtimin e poemave të para sikundër janë *Vaji i bylbylit, I*

¹ Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I*. Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 9.

² Koleç Topalli, *Ndre Mjeda si gjuhëtar*, (Konferencë Shkencore, Ndre Mjedja 150 vjetori i lindjes), „ASHAK”, Prishtinë, 2016.

tretuni dhe më në fund, *Andrra e jetës* e përcakton subjektin lirik dhe epik në ndonjërin më pak e në ndonjërin më shumë i zhvilluar, kurse ndërtimin e poemave të vonshme, sikundër janë *Lissus* dhe *Scodra*, e përcakton tema që është e njëjtë për të gjitha tingëllimat, që do të futen nën titullin e përbashkët.

Ndre Mjedja është ndër poetët tonë, për të cilët është shkruar para e mbas Çlirimit. Në sajë të vlerave poezia e Ndre Mjedjes pëlqehet edhe sot, atëherë do të duhej të theksohen: e përgjithshmja kuptimore e poezive dhe e poemave më të mira; thellimi poetik dhe arsytimi psikologjik i pamjeve të paraqitura; pasuria imagjinare e shikimeve e shprehur me një disiplinë të jashtëzakonshme krijuese; ndjenja dhe mendimi, i krijuar në vargje e jo të përshkruar përmes tyre; mbulimi i idesë dhe i mendimit me fjalën dhe figurën më përkatëse; bashkëveprimi i plotë i pamjeve dhe i figurave në tërësi, qoftë ajo poezi a poemë; ngritja shkallëzore kuptimore dhe emocionale e tërësisë së poezisë a poemës, ngjeshuria e plotë e tyre; larmia e trajtave poetike; larmia në ndërtimin rrokjesor dhe ritmik të vargjeve, me të cilat arrihet gjallërimi kuptimor i përmbajtjes; rima posaçërisht e pasur, që zgjeron mundësitë poetike të gjuhës; përpikëria, pothuaj aritmetikore e shprehjes gjuhësore, që i shërben aq shumë ngjeshurisë kompozicionale dhe ndërtimit ritmik të vargu, e të tjera të ngjashme. Veçoritë e tilla dëshmojnë se me poezinë e Ndre Mjedjes ngritet edhe më lart ndërgjegjja artistike në letërsinë shqipe.

Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i temës për poezinë e Mjedjes ka të bëjë me zbulimin e vlerave të mirëfillta të letërsisë shqipe, pa marrë parasysh që ato janë krijuar në një periudhë, ku Mjeda shfaqet në kulmin e romantizmit dhe u ndal në kohën e zhvillimit të letërsisë moderne. Me temat dhe idetë letrare ai hyn në rendin e rilindësve shqiptarë, kurse me format bëhet poeti i paramodernitetit shqiptar.

Gjithashtu qëllimet e tjera të këtij hulumtimi janë:

- Të njihemi më mirë me autorin Ndre Mjeda dhe veprimtarinë e tij.
- Të thellohem më gjerësisht në analizën e veprave të tij.
- Të gjenden motivet dhe temat që trajtohen në këto vepra.

- Të përcaktohen veçantit e poezive të këtij poeti dhe çfarë e bën atë autor kaq të veçantë.

Rëndësia e punimit

Rëndësia e temës: *Figuracioni në poezinë e Ndre Mjedjes*, qëndron në faktin se veprimtaria letrare e Mjedjes, bën pjesë në kryeveprat e formacionit të romantizmit, por edhe të letërsisë të skalitura në mënyrë mjeshtërore, me lexuesit shqiptarë ka krijuar lidhje emocionale të fuqishme. Studiohet për të njohur mënyrën e ndërtimit të poetikës së Ndre Mjedjes, duke i analizuar ato nga këndvështrime dhe rrafshe të ndryshme, mënyrën e përdorimit të figuracionit dhe stilit në poezinë e tij dhe për t'u hetuar pasqyrimi i poezisë në mentalitetin e shoqërisë së kohës më të gjitha shtresat e saj.

Metodat e hulumtimit

Gjatë këtij punimi kemi bërë një përzgjedhje të formës së punimit, duke u përcaktuar në dy rrafshe të studimit të poezisë së Ndre Mjedjes, ku japim një skemë të punimit, që kjo skemë bëhet metodë e punës sonë në këtë punim. Studimi i poezisë së Mjedjes do të bëhet sipas kësaj skeme: hulumtimi, grumbullimi dhe shfrytëzimi i literaturës, vlerësimi kritik i literaturës dhe sistemimi i saj.

Fazat e kërkimit

Faza përgatitore

- Studimi i poezive të Ndre Mjedjes
- Formulimi i platformës studimore “Figuracioni në poezinë e Ndre Mjedjes”

Faza e mbledhjes së të dhënave

- Studimi i çdo teksti në veçanti
- Studimi i literaturës, analiza e informacioneve dhe të dhënave rreth temës përkatëse

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

- Përqasja me studime të mëparshme
- Analiza të thelluara mbi poezitë e autorit në përgjithësi, motivet dhe temat e trajtuara
- Përgjithësime dhe përfundime

Metodologjia e kërkimit

Për realizimin e këtij punimi duhet të theksojmë se kemi përdorur kryesisht metodën kualitative (induktive), meqë kemi një punim të natyrës teorike dhe krahasimore.

Hipotezat

H1: Ndre Mjedja në poezitë e tij ka arritur të bëjë pasqyrimin e realitetit.

H2: Poezia atdhetare e Mjedjes, në strukturën e saj karakterizohet me figurën e hiperbolës.

H3: Mjedja në krijimtarinë e tij na paraqitet më shumë si realist sesa si romanik.

Struktura e punimit

Strukturalisht, punimi përfshin këto pjesë përbërëse: abstraktin, hyrjen (që përfshin qëllimet, rëndësinë, hipotezat dhe metodologjinë e punimit). Pastaj, punimin do ta ndajmë në tre kapituj, për të cilët do të flasim më gjerësisht në paragrafët në vijim.

Punimi me titull *Figuracioni në poezinë e Ndre Mjedjes* do të përmbajë në vete tre kapituj që njëherësh do të jetë struktura e punimit, dhe që do të pasqyrojë punën time rreth studimit të poezisë së Mjedjes. Ky punim me këtë ndarje në kapituj paraqet disa aspekte të poezisë së Mjedjes, ku kapitulli i parë ka të bëjë më shumë me romantizmin si formacion letrar dhe me poezinë e Mjedjes, për të vazhduar me qëllimet e këtij formacioni dhe poezisë së Mjedjes, ku njëherësh ky kapitull paraqet synimet e studimit të poezisë së Mjedjes. Kapitulli i dytë, në këtë punim do të parashtrojë studimin më të gjerë mbi poezinë e Mjedjes, ku njëherësh në këtë kapitull fillojmë me studimin e poezisë në mënyrë të detajuar, ku bëjmë një studim semantik dhe semiotik mbi poezinë duke sjellë dy rrafshe të studimit mbi poemën *Andrra e jetës*, poemthave të tjerë dhe disa poezive, ku synojmë të plotësojmë këtë aspekt të studimit, gjithmonë duke qenë nën përmasat e temës së paracaktuar. Në

kapitullin e tretë, do të paraqesim studimin mbi poemat sonetike të Mjedjes, duke i analizuar këto poema në bazë të kriterit në fjalë, që gjithmonë kemi parasysh, këtu metodën e studimit për të cilën jemi përcaktuar. Po ashtu, kemi dhënë edhe përfundimet e nxjerra gjatë punimit dhe bibliografinë.

KAPITULLI I

1.1. Ndre Mjeda, intelektual i që ia kushtoi jetën Shqipërisë

Ndre Mjeda, ishte njëri ndër poetët, veprimtarët dhe atdhetarët më të shquar të kohës. Ai krahas Fishtës, Gurakuqit, Nolit, Mosit, veptoi në drejtim të zgjimit dhe kalitjes së ideve përparimtare, pavarësisht petkut të tij fetar. I pajisur me dije filozofike, gjuhësore, fetare, shoqërore, Mjeda me tërë qenien iu kishte përkushtuar arsimimit dhe përparimit të bashkëkombësve, të cilët në kohën e tij, të paarsimuar kombëtarisht, analfabetë e të nëpërkëmbur nga fuqitë e mëdha dhe nga Perandoria Osmane, po përpëliteshin mes Lindjes e Perëndimit. I orientuar drejt vlerave demokratike dhe botës së qytetëruar, Ndre Mjeda përfaqësonte intelektualin model të kohës, me një kulturë të shëndoshë kombëtare e shoqërore, me një modesti karakteristike të njerëzve të rangut të tij dhe me një botë të pasur krijuese, të cilën e vuri në shërbim të arsimimit dhe emancipimit të shqiptarëve pa dallin krahine, feje e bajraku. Veprimtaria poetike, gjuhësore, filozofike e fetare e Mjedjes është mjaft e thellë si nga përmbajtja ashtu edhe nga qasja që iu ka bërë problemeve të caktuara. Ai ka shkruar poezi antologjike, të cilat me të drejtë janë prezantuar në abetaret shqipe dhe në librat shkollorë. Janë të mirënjohura poemat e tij si: “Ëndrra e jetës”, Vaji i Bylbylit, Liria, Lissus, Scodra e të tjera.³

Ndre Mjedja u lind në Shkodër nga i ati Jakë Zefi dhe ëma Luçije Thaçi. I ati ishte me origjinë nga Mirdita ndërsa e ëma nga Malësia e Pukës. Si i ri me intelekt të zhvilluar, i talentuar dhe studioz, tërhoqi vëmendjen e jezuitëve, të cilët menduan ta bënin prift. Në edukimin e tij patën ndikim shkrimtari jezuit Anton Xanoni (1863-1915) dhe poeti françeskan Leonardo de Martino (1830-1923). Ai vazhdoi më pas studimet fetare në Spanjë, Itali e Poloni. Në fillim ndenji tre muaj në pranverë 1880 në fshatin Cossé-le-Vivien afër Lavalit në perëndim të Francës, kurse më pas ndoqi një kolegji në manastirin Kartuzian të Porta Coeli-t në veri të Valencias në Spanjë, ku studioi për letërsi.⁴

³ KultPlus. *Ndre Mjeda, intelektual i që ia kushtoi jetën Shqipërisë*. 11 Gusht, 2020. Marrë në: <https://www.kultplus.com/tag/ndre-mjeda/>

⁴ Po aty

1.2. Romantizmi si drejtim dhe metodë letrare krijuese

Romantizmi në letërsinë shqipe, ose romantizmi shqiptar është periudha në pikëpamje stilistike, më homogjene e letërsisë shqipe. Në qoftë se deri në shekullin XIX, letërsia popullore është krijimtaria qendrore shpirtërore në jetën e shqiptarëve, në periudhën e romantizmit letërsia e kufizuar nis të bëhet dhe dikur nga fundi i shekullit, edhe bëhet aktiviteti qendror mendor i kombit.⁵

Rreth formacionit letrar të romantizmit dhe letërsisë romantike shqipe, do të sjellim disa përkufizime të studiuesit Rexhep Qosja në vijim: *“Krijimtaria gjuhësore artistike në këtë kohë, në shumicën e rasteve është krijimtari, që sintetizon veçoritë e fushave të ndryshme të krijimtarisë shpirtërore dhe është një krijimtari e tillë sintetizuese, sepse në jetën historike të kombit ende nuk janë diferencuar plotësisht as sferat e jetës kulturore, as institucionet politike, shoqërore dhe kulturore.*

Rezultat i konceptit të tillë të letrarizimit romantik, në njërin anë, dhe i rrafshëve të analizuar në anën tjetër, është edhe dallimi, që realizohet ndërmjet nocionit romantizëm, me të cilin shënohet letërsia e shekullit të kaluar. Pavarësisht pse shkrimtarët e periudhës së romantizmit e krijojnë vetëm nocionin rilindje me të mbulojnë periudhën dhe shpjegojnë idealin e krijimtarisë së tyre, aq më parë studimi modern historiko - letrar, i bazuar në parimet e poetikës strukturale historike, që mund të realizohet vetëm në saje të nocioneve dhe të termave që janë terma të shkencës së letërsisë.

Përdorimi i termave që janë terma të shkencës letrare, në vend të termave të historisë politike për cilësimin e formacioneve stilistike, dhe të periudhave letrare, sjellë konkluzionin se krejt letërsia e Rilindjes Kombëtare, nuk mund të quhet romantike jo vetëm pse krijuesit e saj të fundit të romantizmit evropian, por para se gjithash, pse rrafshet në të cilat studiohet letërsia e romantizmit shqiptar, në këtë mes e dëshmojnë çintegrimin e saj gjithnjë e më të dukshëm duke filluar prej dhjetëvjetëshit të fundit të shekullit XIX.

Periudha historike në të cilën e shënon letërsia e romantizmit, që në historinë politike, të popullit shqiptar quhet Rilindja Kombëtare, është periudhë e një jete të jashtëzakonisht të vrulltë kombëtare politike, kulturore dhe letrare. Në këtë kohë të madhe janë bërë ndryshime

⁵ Rifat Ismaili, *Historia e letërsisë shqipe II*. Prishtinë, 2000.

të mëdha në jetën historike, prandaj edhe në jetën shpirtërore të shqiptarëve. Romantizmi është letërsi e këtyre ndryshimeve: ai i nxit dhe i dëshmon ato.

Në historinë e letërsisë shqipe, romantizmi shënon kthesë me përmbajtjen tematike, me procedimet e realizmit të saj, me përdorimin e materialit gjuhësor.⁶ Gjithsesi, romantizmi sjell edhe një gjuhë të re, edhe një filozofi të re mbi historinë, mbi natyrën dhe mbi njeriun, prandaj edhe një etikë të re - çka nuk mund të thuhet për letërsinë e periudhave të tjera. Vlerat e tij estetike dhe teorike, në njërën anë, kurse funksionet e tij historiko - letrare dhe etike, në anën tjetër, janë aq shumë të shquara në historinë e letërsisë shqipe sa që bëhen vendimtare për krejt kulturën kombëtare shqiptare.

Me gjuhën, me gjinitë, me llojet dhe me format, me ligjësitë metriko - ritmike të vargut, me prijet e saj, me funksionin e saj themelor kombëtar, letërsia e romantizmit shqiptar, objektivisht, është mëma e madhe në të cilën derdhen rrjedhat më të rëndësishme të të shkuarës letrare dhe kulturore në gjuhën shqipe.

Qosja thekson se me letërsinë e romantizmit fillon demokratizimi i letërsisë dhe i kulturës shqiptare. Pas letërsisë fetare, që, objektivisht i shërben krejt popullit, domethënë Kombit.

Letërsia e romantizmit është letërsi që u përgjigjet dhe, madje u prin kohëve historike në jetën e popullit shqiptar. Në qoftë se historia e botës - si thotë Hegeli - është përparim në vetëdijen për lirinë, atëherë mund të thuhet se letërsia e romantizmit shqiptar është vetëdija më e pjekur, më e lartë, më e përparuar për lirinë tonë.

Pavarësisht prej pasioneve dhe prej ngarkesave të kohëpaskohshme folklorike dhe mitologjike të vetëdijes së tyre; pavarësisht prej anakronizmit të kohëpaskohshëm të gjuhës së tyre poetike aq dukshëm herë - herë zmadhuese, shkrimtarët e romantizmit shqiptar janë, njëkohësisht krijuesit e një etosit të ri kombëtar në formimin e etosit të lartë kombëtar.

Vlerat dhe funksionet e tilla të letërsisë së romantizmit në letërsinë, në kulturën dhe, tekembramja, në historinë e popullit shqiptar kushtëzojnë rëndësinë e saj të përgjithshme,

⁶ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi I*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 9-10

*këtu të shprehur edhe përmes vëllimeve të sintezës që i kushtohen, në krahasim me vëllimet mbi periudhat e tjera të letërsisë shqipe.*⁷

Letërsia e romantizmit shqiptar, ka përmbajtjen e atdheut, por është krijuar dhe publikuar nëpër vende të huaja, para se gjithash, nëpër kolonitë shqiptare. *Kolonitë shqiptare që përcaktojnë strukturën hapësinore të romantizmit shqiptar, duke pasur parasysh, në radhë të parë, vlerën artistike të veprave, po aq sa edhe prirjet e reja ideotematike dhe stilistike që sjellin dhe vendin që autorët e tyre zënë në historinë e letërsisë shqipe, posaçërisht të romanizmit shqiptar, do të dilte se kolonitë që i kontribuojnë më së shumti letërsisë shqipe, që ndikojnë në rrjedhat dhe në prirjet e saj historike letrare dhe që, më në fund, caktojnë strukturën hapësinore të periudhës së saj romantike janë: Koloni e Arbëreshëve të Italisë, Kolonia e Shqiptarëve të Stambollit, Kolonia e Shqiptarëve të Kajros dhe Kolonia e Shqiptarëve të Sofjes.*⁸

Kolonia e Kajros - në qoftë se merret për bazë formimi i shoqërive kulturore apo nxjerrja e gazetave a revistave mund të shihet se aktiviteti i organizuar i kësaj kolonie është, po ashtu, i vonë në krahasim me aktivitetin e organizuar të Kolonisë së Arbëreshëve të Italisë apo të Kolonisë së Shqiptarëve të Stambollit. *Ekzistojnë, ndërkaq dëshmi të tjera, në bazë të të cilave mund të pohohet se idetë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare depërtojnë relativisht herët ndër shqiptarët e kësaj kolonie. Në qoftë se ndër shqiptarët e kësaj kolonie akoma nuk kishte poetë të shquar, të njohur, si Naim Frashëri, Pashko Vasa, Jorenim De Rada, Gavril Dara i Riu, Zef Serembe apo si Ndre Mjedja.*⁹

Në historinë e letërsisë shqipe, ndërkaq Kolonia e Shqiptarëve të Kajros, ka rëndësi, në radhë të parë, për përmbledhjen e thesarit popullor. Romantizmi i Kolonisë së Shqiptarëve të Kajros, ndërkaq, përpos prirjes folklorike e shquan më dukshëm edhe një prirje tjetër që do të mbizotërojë në periudhën pasuese: prirjen e realizmit. Qëndrimi, pak a shumë, më realist ndaj tematikës historike, në njërën anë, kurse më kritik ndaj problemeve shoqërore dhe zakoneve kombëtare, në anën tjetër, nuk mund të konsiderohet vetëm pasojë e

⁷ Po aty, fq. 11-12

⁸ Po aty, fq. 16

⁹ Ndrçim Kulla, *Poetë të mëdhenj në letërsinë dhe historinë shqiptare*. Plejad, Tiranë, 2006.

evolucionit të letërsisë romantike, se në atë rast një evolucion të tillë do të duhej ta pësonte edhe letërsia e kolonive të tjera shqiptare, madje, edhe e arbëreshëve.¹⁰

*Duke jetuar, ashtu, në mjedise të huaja, me mentalitete, me zakone, me shprehi, domethënë me kultura të tjera, në të cilat nuk mund të inkuadrohen dhe të përshtaten lehtë, shqiptarët e mërguar me kohë e ndjejnë nevojën e realizimit të tyre shpirtëror dhe kulturor.*¹¹

1.3. Veprat e Ndre Mjedjes si krijime poetike

Ndre Mjeda është njëri prej poetëve të romantizmit shqiptar, që ka lënë pak poezi dhe poema. Për të gjallë ka botuar përmbledhjen e poezive e të poemave me titullin *Juvenilia* (1917), poemën tingëllimore *Lissus* (1921) dhe poemën tjetër tingëllimore *Lirija* (1937), kurse të botuara nëpër revista e gazeta, apo në dorëshkrim ka lënë edhe disa poezi të tjera, që nuk shquhen me vlerën artistike të tyre.

*Vargjet e para Ndre Mjedja i shkruan në vitin 1886, kur fillon të shkruajë poezi e poema dhe merret me përkthime poetike. Në këtë vit e fillon poemën e tij më të njohur dhe gjithsesi, më të mirën, *Vaji i bylbylit*; shkruan poezinë *Skënderbeu*, që më vonë, do ta quajë *Varri i Skënderbeut*, dhe poezinë *Jetimi*, pastaj shkruan poezinë *Kënga e Mahmud Pashës*, përkthen poezitë e njohura *Bija e verbt ç'prej t'lemi*, *Vllavrasësi i Tosknis*, *I'varruemit e Sir John Moore*, në vitin 1887, ndërkaq shkruan poezitë e njohura *I vorfni dhe Malli për mymleqet*, që më vonë do ta quaj *Malli për atdhe*.¹²*

Në qoftë se nuk e marrim parasysh poemën *Vaji i bylbylit*, atëherë do të mund të thuhet se edhe Ndre Mjedja, por si shumica e romantikëve tanë të tjerë - pors Jeronim de Rada, nga fillimi dhe pors Naim Frashëri, nga fundi i romantizmit - krijimtarinë e tij poetike e fillon me shkrimin e vjershave lirike.

Njëra prej vjershave të tij të para *Skënderbeu*, së cilës, më vonë, do t'ia ndërroj titullin dhe do ta quajë *Varri i Skënderbeut* edhe me disponimin që në të shprehet, e vazhdon plotësisht prirjen mbizotëruese të lirikës sonë atdhetare romantike. Krahas poezive të tilla, sikundër

¹⁰ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi I*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 33-34

¹¹ Mentor Quku, *Mjeda 1-8, Ilar*. Tiranë, 2004-2010.

¹² Latif Sermahaj, *Poetika e Ndre Mjedjes*. Asdreni, Shkup, 2010.

është poezia *Varri i Skanderbeut*, Ndre Mjedja do të shkruajë edhe një tip tjetër të poezisë: tipin e poezisë me subjekt. Njëra prej poezive të tij të para, e ndërtuar mbi subjektin, është poezia *I mbetuni*, e shkruar në vitin 1887, e cila, para se të botohet në përmbledhjen *Juvenilia* (1887), do të ketë edhe dy tituj të tjerë: së pari *Jetimi e*, pastaj *I vorfni*.

Porsi numrin më të madh të vjershave e të poemave të tjera ashtu edhe vjershën *I mbetuni*, Ndre Mjedja e shkruan jashtë atdheut.

Në vjershën *I mbetuni* Ndre Mjedja e rrëfen jetën e një të varfëri, i cili, megjithëse babai i është vrarë në luftë për atdheun, është i detyruar të lypë derë më derë në mënyrë që, në fund, të vdesë pranë varrit të prindërve. Me subjektin e kësaj vjershe, kryesisht, të shkurtër, që përfaqëson një tregim të gjatë, Ndre Mjedja sikur i parasheh disa prej dukurive sociale dhe morale, që do të shprehen në jetën shoqërore të atdheut të tij pas shpalljes së pavarësisë, jo vetëm se nuk do t'i korrin frytet e luftës së prindërve të vet, por, në disa raste, do të gjenden në situata të rënda sociale.

Në qoftë se me theksin social shpreh një prirje, sado kudo, të butë të përmbajtjes, me ndërtimin e saj poezia I mbetuni, bashkë me poezitë e tjera të ndërtuara mbi subjektin, shpreh një prirje themelore të procedimit të Ndre Mjedjes. Në të jeta e njeriut përsiatet përmes pamjesh të sendërtuara me figura; metafizika lirike jepet përmes sendërtimit të figurshëm. Ndjenja e sendërtuar në poezi përforcohet me mjetet, që do të përdoren edhe në poezitë e tij të tjera. Kështu, për shembull, fjalët babi i vdekur, uria, skamja, murlani, bora, varret, shpirti e disa të tjera janë fjalë më të theksuara që shquajnë emocionalizimin e saj. Kemi në të edhe simbolin e nënës, që do të paraqitet edhe në disa prej vjershave të tij të mëvonshme dhe mallin, që ia shkakton të mërguarit që, po ashtu, do të paraqitet në disa prej vjershave të tij të mëvonshme. Në poezinë I mbetuni, ndërkaq, do të shprehen edhe disa risime të tjera, që do të shquajnë poezinë e Ndre Mjedjes, në krahasim me poezinë e romantikëve tanë të tjerë. Kështu, për shembull, në të kallëzohet me një tetërrokësh tregimtar, i cili me ndryshim prej tetërrokëshit popullor që është varg me prirje të rënjes, është varg me prirje të ngritjes, që e bartin rimat fundore: lot - thot; lis - molis, pushoj - fluturoj, lot - kot, e të tjera.¹³

¹³ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi - III*, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq. 431-432

Në qoftë se poezia *I tretuni*. Titulli e parë të poezisë, *Malli për mymleqet*, me të cilin edhe botohet në vitin 1887, Ndre Mjedja e zëvendëson me titullin *Malli për atdhe*, me qëllim që prej tij të heqë fjalën e huaj: mymleqet.

Sikundër edhe thotë titulli, në këtë poezi trajton një prej temave të shpeshta dhe pothuaj, më emocionale të poezisë së tij: temën e mallit për atdhe, që si ndjenjë, do ta shprehë, pothuaj, në pjesën më të madhe të poezive dhe poemave që do të shkruajë nëpër vende të ndryshme të huaja, ku do të studiojë teologjinë dhe filozofinë. Titulli, *Malli për atdhe*, është një titull karakteristik dhe deri në një masë edhe shpjeguese, sikundër edhe titujt e disa poezive a poemave të tjera të Ndre Mjedjes, për shkak se në të jepet jo vetëm tema e poezisë – atdheu, por edhe qëndrimi i poetit ndaj saj – malli që ndien.

Në poezinë *Malli për atdhe*, ndërkaq, do të shprehet edhe një prej veçorive dalluese të disa vjershave të Ndre Mjedjes: në njërën anë, romantike për nga përmbajtja dhe ndjenja e përforcuar, në anën tjetër, ajo është neoklasiciste për nga dhjetërokëshi tregimtar, me të cilin më tepër kallëzon se që sugjeron për nga strofat safike.

*Tema më e shpeshtë në krijimtarinë e tij poetike, është malli për atdhe Ndre Mjedja e paraqet edhe në një poezi tjetër të fillimeve krijuese: në poezinë Shtegtari që në dorëshkrim, kishte titullin Shtegtari derdimen.*¹⁴ Edhe këtë poezi me subjekt tregohet për një shtegtar që nxiton të mbërrijë në shtëpi të vet. As qytetet, as fshatrat, as dasmat, as festat në të cilat has rrugës, nuk mund t'ia ndalin hapat me të cilët niset drejt shtëpisë. Gëzimi që e pret përnjëherë do t'i kthehet në pikëllimin të madh, që mund të pësojë njeriu në jetë: para se të arrijë në shtëpi i gjen të vdekur gruan me fëmijët që kishin dalë ta presin. Nuk ka dyshim se në vjershën *Shtegtari* theksohet tragjizmi i jetës. Të gjitha mjetet e shprehjes poetike në të janë vënë në shërbim të përforcimit emocional të saj.

Ndër poezitë që Ndre Mjedja që i shkruan në fillimet e krijimtarisë së tij është edhe poezia *Uzdja pa dobi* (1889). I bindur se ajo nuk ka vlerë artistike apo, madje se nuk ka vlerën artistike të poezive të tjera, ai nuk do ta fusë, mandej, në përmbledhjen *Juvenilia* (1917). Poezia *Uzdja pa dobi* është e shkruar në trajtën e bashkëbisedimit të imagjinuar të subjektit poetik, me nënën mbi porositë që ajo ia kishte dhënë dikur. Për ndryshim prej poezive të tjera të shkruara në këtë kohë, në të cilat herët më të shpeshta, tema shikohet prej një

¹⁴ Po aty, fq. 434

largësie, pak a shumë të dukshme me çka bëhet e mundshme paraqitja objektive e saj, *Uzdja pa dobi* është poezia e parë, në të cilën Ndre Mjedja nuk nguron të japë porosi, por natyrisht, porosi atdhetare. Ndjenja atdhetare, që në poezitë e tjera shprehet përmes mallit të madh, të të mërguarit për atdhe, këtu në poezinë *Uzdaja pa dobi*, shprehet përmes didaktizmit, që, ç'është e vërteta, nuk do të cilësojë as poezitë as poemat e mëvonshme të Ndre Mjedjes.

Me vlerën më të dalluar artistike poezia *Varri i Skanderbeut*, nuk shquhet aq sa poezia *Gjuha shqipe*, të cilën Ndre Mjedja ia kushton albanologut të njohur të kohës së tij, Gustav Majerit. E shkruar jashtë Shqipërisë, është e kuptueshme pse kjo poezi do të jetë dukshëm e përshkruar, prej mallit për atdheun. Pasi edhe disa poezi të tjera të shkruara në këtë kohë, ashtu edhe poezia *Gjuha shqipe*, do të sjellë ndjenja e qëndrimet e njohura të poezisë sonë romantike, të viteve të pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por njëkohësisht do të sjellë edhe disa thekse të reja. Edhe Ndre Mjedja mendon se gjuha është pothuajse, ajo vlere më e lartë që i ka mbetur popullit, që përfaqëson qenësinë e kombit dhe që i bashkon të gjithë shqiptarët; toskët dhe gegët, katolikët e myslimanët dhe ortodoksët.

Në qoftë se në poezinë kushtuar Gustav Majerit, *Gjuha shqipe*, megjithatë, sjell përkushtim të ri atdhetar, përkushtimin ndaj njohjes diturore të gjuhës shqipe e të prejardhjes së saj, në poezinë tjetër, të kësaj kohe, në poezinë *Për një shkollë shqipe mbyllun prej qeverisë otomane* të shkruar më 1902, Ndre Mjedja sjell një temë të njohur por të paraqitur me një zë, që nuk ta cilësojë kurrë poezinë e tij: me zërin e prisit të masave. Në këtë poezi ai shpreh mospajtimin, në të vërtetë, pezmin e tij për shkak se qeveria otomane mbyll shkollën shqipe. Këtu paraqitet frika e këtij pushteti prej arsimit të shqiptarëve dhe habinë që i sjell një frikë e tillë, për të e pakuptimtë. Prej kësaj poezie mund të shihet se Ndre Mjedja, megjithëse prift, botëkuptimin e të cilit e përcakton doktrina fetare, i kupton ligjësitë historike shumë më mirë sesa numri më i madh i romantikëve tanë të tjerë. Për këtë arsye mund të shpreh bindjen se pengesat që sunduesit otomanë ia vënë arsimit të shqiptarëve vetëm sa do ta shtojnë dëshirën e tyre për shkollim të mëtejshëm.

Fillimet krijuese të Ndre Mjedjes u takon edhe poezia *Mahmud Pasha në Mal të Zi* e cila, në ndryshorin e parë, të botuar në Shahirin Elierz, kishte titullin *Kënga e Mahmud Pashës*.

Pavarësisht se si e kishte filluar edhe se si e kishte titulluar në fillim, vjersha *Kanga e Mahmud Pashës*, përkatësisht vjersha *Mahmud Pasha në Mal të Zi*, nuk mund të quhet këngë në kuptimin në të cilin i quan ashtu një numër të vjershave të tij të improvizuara Zef Serembe dhe, nuk mund të quhet ashtu, këngë, para se gjithash, për arsye se këngëtimi nuk është pikënisja krijuese, kurse melodia nuk është zotëruesja e saj. E shkruar si himnizim i luftërave të popullit shqiptar kundër sulmuesve të huaj e, sidomos, si himnizim i trimërisë së Mahmud Pashës së Bushatlive, ajo spikat me stil të lartë që do të kushtëzojë patosin dhe retorizmin e saj.

*Dukshëm më e plotë kuptimisht dhe dukshëm më e vlefshme artistikisht është vjersha tjetër atdhetare, paramenduar si vjershë portret, në të cilën Ndre Mjedja e paraqet një pasha tjetër shqiptar: vjersha Mustafa Pasha në Babune. Rëndësia e dyfishtë e kësaj vjershe qëndron: në mjeshtërinë poetike me të cilën e sendërton atë ide. Ndjenja që në të krijohet është e fortë, por jo e vrazhdë, kurse toni i saj është i lartë, por jo çjerrës. Fuqia e idesë dhe e ndjenjës së krijuar në të mbështet në përdallimin e paraqitur ndërmjet jetës së rëndë të malësorëve, të flijimeve që bëjnë, të luftëtarëve në të cilat shkojnë, të skamjes në të cilën i lënë familjet ata, në njërën anë, kurse të jetës së shfrenuar të Mustafa Pashës, që e kalon kohën mbi thasë të florinjte, ndër valle të jevgeve, në lodra dudumash, duke grabitur pasurinë e popullit, përgjithësisht, në anën tjetër.*¹⁵

Në qoftë se në vjershën *Bashkonju* - me përmbajtjen dhe me titullin e saj — shpreh prirjen mbizotëruese të poezisë romantike shqipe të fundit të shekullit XIX, në të cilën këndohen gjuha, lavdi historik, bashkimi i shqiptarëve pa dallim feje a të folmeje, vjershat *Mikut tem Pal Moret-it* dhe *Mikut Pal Moret-it*, Ndre Mjedja paralajmëron prirjen e re të vjershave a të poemave të tij atdhetare, në të cilat do të këndojë origjinën e lashtë të popullit të vet. Në to, rëndom, gërshetohen gjykime dhe vlerësime a politike dhe përsiatje për të shkuarën e largët.

Kurse në poezinë *Pal Moretin* përsiatet e kaluara e largët, ku e gjykon gatishmërinë e Italisë, që t'i japë topa Turqisë. Në këtë mënyrë, duke gjykuar politikën e vazhduar të mbretit Umberto, që ishte bërë i njohur për nga dhuna dhe shtypja e lirive demokratike, po aq sa edhe për nga përpjekjet e pushtimit të tokave të huaja, Ndre Mjedja do të gjykojë çdo

¹⁵ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi-III*, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq. 439-440

politikë militariste pikërisht në një kohë ku militarizmi bëhej rrezik gjithnjë e më i madh për botën. Edhe këto poezi ndërtohen sipas parimit të ballafaqimit të pamjeve, të ideve, e të ndjenjave të kundërta. Derisa në një rën anë, kemi gjykimin e pushtuesve, në anën tjetër, kemi pamjet baritore të jetës së lashtë ilire.

Sikundër mund të shihet me kohë gjithnjë e më dukshëm, Ndre Mjedja do ta kërkojë përmbajtjen e poezive të tij, në të kaluarën e largët historike a mitologjike. Një largim i këtillë, sado ende i kufizuar, prej bashkëkohësisë, doemos sjell disa ndryshime dhe në ndërtimin ideoemocional të poezive të tij.

Vjershat e fillimeve krijuese, në të cilat subjekti bëhet bartës i domethënies së tyre, e tregojnë fare qartë dhuntinë e Ndre Mjedjes, për krijimin e poemave. Poemat gjithsesi përbëjnë pjesën më të rëndësishme si nga pikëpamja historiko - letrare, ashtu edhe nga pikëpamja artistike e krijimtarisë së tij.

Poemat e Ndre Mjedjes ndryshojnë shumë prej poemave të tjera të romantizmit shqiptar, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga ndërtimi kompozicional. Kur më pak e kur më shumë, ato ndryshojnë edhe njëra prej tjetrës: poemat që shkroi dhe që do të shkruan më vonë, sidomos në fund të krijimtarisë. *Ndërtimin e poemave të para sikundër janë Vaji i bylbylit, I tretuni dhe më në fund, Andrra e jetës e përcakton subjektin lirik dhe epik në ndonjë rën më pak e në ndonjë rën më shumë i zhvilluar, kurse ndërtimin e poemave të vonshme, sikundër janë Lissus dhe Scodra, e përcakton tema që është e njëjtë për të gjitha tingëllimat, që do të futen nën titullin e përbashkët.*¹⁶

1.4. Objekti i studimit

Ndre Mjedja është ndër poetët tonë, për të cilët është shkruar para e mbas Çlirimit. Në saje të vlerave poezia e Ndre Mjedjes pëlqehet edhe sot, atëherë do të duhej të theksohen: e përgjithshmja kuptimore e poezive dhe e poemave më të mira; thellimi poetik dhe arsyetimi psikologjik i pamjeve të paraqitura; pasuria imagjinare e shikimeve e shprehur, me një disiplinë të jashtëzakonshme krijuese; ndjenja dhe mendimi, i krijuar në vargje e jo të përshkruar përmes tyre; mbulimi i idesë dhe i mendimit me fjalën dhe figurën më përkatëse;

¹⁶ Mark Gurakuqi, *Arti i Mjedës, Vëzhgime kritike*. Prishtinë, 1978, faqe 33

bashkëveprimi i plotë i pamjeve dhe i figurave në tërësi, qoftë ajo poezi a poemë; ngritja shkallëzore kuptimore dhe emocionale e tërësisë së poezisë a poemës, ngjeshuria e plotë e tyre; larmia e trajtave poetike; larmia në ndërtimin rrokjesor dhe ritmik të vargjeve, me të cilat arrihet gjallërimi kuptimor i përmbajtjes; rimari posaçërisht i pasur, që zgjeron mundësitë poetike të gjuhës; përpikëria, pothuaj, aritmetikore e shprehjes gjuhësore, që i shërben aq shumë ngjeshurisë kompozicionale dhe ndërtimit ritmik të vargut, e të tjera të ngjashme. Veçoritë e tilla dëshmojnë se me poezinë e Ndre Mjedjes ngritet edhe më lart ndërgjegjja artistike në letërsinë shqipe.

Si shkrimtar që krijimtarinë letrare dhe diturore e fillon në gjirin e romantizmit shqiptar, dhe në pajtim me programin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, është plotësisht e kuptueshme pse poezia e Ndre Mjedjes, tregon mjaft veçori të poezisë krijuesve të etapës së parë dhe të etapës së dytë, të romantizmit. Poezia e krijuesit me dhunti natyrore dhe me kulturë letrare, poezia e tij, ndërkaq, tregon edhe disa cilësi të tjera, që e veçojnë në gjirin e poezisë sonë romantike në përgjithësi, e në saje të të cilave mund të flitet për poetikën e tij të pavarur.

Një prej veçorive të tjera dalluese të poetikës së Ndre Mjedjes është ngjeshuria e poezive dhe e poemave të tij. Me ndryshim prej romantikëve tanë të shquar, sikundër, janë Jeronim de Rada, Gavril Dara i Riu madje Naim Frashëri, të cilët, kur më pak e kur më shumë, i copëzojnë poemat apo madje edhe poezitë e tyre. Ndre Mjedja sikur kujdeset që të shquajë ngjeshurinë e tyre.

Një veçori tjetër dalluese e poezisë së Ndre Mjedjes është stilizimi. Gjuha e poezisë si gjuhë e çrëndomësuar në përgjithësi është gjuhë e stilizuar. Roli i stilizimit është më i dukshëm, më i fortë, më vendimtar në poezitë dhe në poemat e Ndre Mjedjes. Ndre Mjedja i kushton kujdes posaçërisht të madh vargut dhe, në përgjithësi, shprehjes.

Veçori tjetër dalluese e poetikës së Ndre Mjedjes janë edhe përshkrimet e njëmendësisë, kryesisht të pamjeve të natyrës që përfaqësojnë një trajtë tjetër stilizimi në krijimtarinë e tij poetike. Ndryshimet dhe risitë që Ndre Mjedja sjell në vargun e romantizmit shqiptar dhe në përgjithësi, në vjershërimin shqip, në një pjesë të madhe, u detyrohen edhe bartjeve, që zbaton aq shpesh në poezinë e tij. Bartje sidomos të fjalëve mund të gjenden edhe në vargjet e disa romantikëve të tjerë, posaçërisht në vargjet e Naim Frashërit, por bartjet në vargjet e Ndre Mjedjes janë aq të shpeshta, dhe aq ndikuese në ndërtimin e tyre rrokjesor

dhe ritmik, saqë mund të quhen veçori dalluese e vjershërimit të ti. Për shkak të rolit të tillë të bartjeve disa nga vargjet e tij, po të mos ishte rima, si përbërës i domosdoshëm i tyre, do të mund të trajtoheshin si vargje të lira.

Ndre Mjedja krijon shumë rima dhe madje, shumë rima të ndryshme, varësisht prej mënyrës së këmbimit të tyre në strofë, përpos të tjerash, krijon rima të rrafshëta (aabb); të puthura (aaa) e të tjera të ngjashme.

Në poezinë e Ndre Mjedjes gjenden edhe strofa që në tërësi, mund të çmohen si strofa të përbëra prej vargjesh, të cilave u janë marrë, përkatësisht u janë ngjitur tërësi kuptimore theksore të vargjeve paraprake të vargjeve pasuese.

Prej mënyrës së përdorimit të lëndës gjuhësore, prej ndërtimit të vargut, prej llojeve të strofave e të poezive, prej kompozicionit të poemave, më në fund, prej krijimtarisë së tij poetike në përgjithësi, shihet se Ndre Mjedja ishte krijues me disa njohuri të caktuara teorike për poezinë. Përpos për poezinë, gjatë gjithë jetës së tij krijuese Ndre Mjedja do të interesohet edhe për një fushë tjetër, edhe për gjuhën shqipe. Interesimet e tij për gjuhën shqipe janë, njëkohësisht, interesime të poetit, të historianit dhe të gjuhëtarit. Sikundër edhe shumica e romantikëve tanë të tjerë, ashtu edhe Ndre Mjedja përkushtimin e tij të theksuar ndaj gjuhës shqipe, para se gjithash, e shprehë si poet, në disa poezi. Kështu, për shembull për gjuhën shqipe ai shkruan poezitë: *Për një shkollë shqype mbyllun prej Qeverisë Otomane, Bashkonju* dhe më në fund, *Gjuha shqype*, që ia kushton albanologut të njohur, Gustav Majerit.

Në poezitë për gjuhën shqipe ai kryesisht, shpreh pikëpamje dhe ndjenja të ngjashme si edhe romantikët e tjerë, kur shkruajnë për të. Edhe për të gjuha është dëshmia më e rëndësishme e origjinës së lashtë të shqiptarëve; ajo e tregon mëvetësinë etnike dhe i njëson pjesëtarët e kombit.

*“Shumësia e shkrimeve kritike, eseistike dhe historiko - letrare mbi poezinë e tij lejon të pohohet se si kjo poezi i ka dhënë nxitje kritikës së sotme shqipe, që të jetë më kërkuese dhe më e llojllojshme për nga metodat dhe për nga trajtat”.*¹⁷

¹⁷ Alfred Uci, *Probleme të estetikës*. Rilindja, Prishtinë, 1980, f. 33.

Në qoftë se flitet sot për të metat e poezisë së Ndre Mjedjes, atëherë do të mund të thuhet se: kujdesi i tij i njohur për trajtën nuk është gjithmonë, në të njëjtën masë, i përcjellë edhe prej kujdesit për thellimin e përmbajtjes e të kuptimit; poemat tingëllimore *Lissus* dhe *Scodra*, janë shembujt më të dukshëm, dhe të vetmit, të trajtës, që nuk sjell dhe domethënien përkatëse në krijimtarinë e tij poetike; vargjet e tingëllimave sidomos, të poemave tingëllimore, shpesh s'kanë natyrë të vargut shqip; poezitë atdhetare nuk janë gjithmonë të liruara, prej patetizmit dhe prej retorizmit të njohur romantik; gjuha e shkrimeve të tij, si gjuhë e Gropës së Shkodrës, është gjuhë e ngushtë, vendëse, dhe nuk shpreh prirjen mbizotëruese të gjuhës së romantizmit shqiptar.

Në qoftë se flitet për vlerat, në saje të të cilave poezia e Ndre Mjedjes pëlqehet edhe sot, atëherë do të duhej të theksohen: e përgjithshmja kuptimore e poezive dhe e poemave më të mira; thellimi poetik dhe arsyetimi psikologjik i pamjeve të paraqitura; pasuria imagjinare e shikimeve, e shprehur me një disiplinë të jashtëzakonshme krijuese; ndjenja dhe mendimi, i krijuar në vargjet e jo të përshkruar përmes tyre; mbulimi i idesë dhe i mendimit me fjalën dhe me figurën më përkatëse; bashkëveprimi i plotë i pamjeve dhe i figurave në tërësinë, qoftë ajo poezi apo poemë; ngritja shkallëzore kuptimore dhe emocionale e tërësisë së poezisë apo poemës, ngjeshuria e plotë e tyre; larmia e trajtave poetike; larmia me ndërtimin rrokjesor dhe ritimik të vargjeve, me të cilat arrihet gjallërimi kuptimor i përmbajtjes, rima posaçërisht e pasur, që zgjeron mundësitë poetike të gjuhës, përpikëria, pothuaj, arithmetike e shprehjes së gjuhësore, që i shërben aq shumë ngjeshurisë kompozicionale dhe ndërtimit ritmik të vargut, e të tjera të ngjashme.¹⁸

¹⁸ Po aty, fq. 507

KAPITULLI II

2.1. Semantika e poezisë së Mjedjes

Juvenilia përmbledhje me poezi

Kjo përmbledhje me poezi e Ndre Mjedjes, është njëra ndër veprat kryesore të tij, që përmban poezi, poemën *Andrra e jetës* dhe poemthet *Vajin e bylbylit* dhe *I tretuni*. Përmbledhja me poezi *Juvenilia* fillon me poemthin *Vaji i bylbylit* dhe vazhdon me *I tretuni* poemën *Andrra e jetës* dhe pastaj me disa poezi. Kjo strukturë e ndërtimit të kësaj përmbledhjeje, përbën formën e ndërtimit të veprës *Juvenilia*. Në këtë vepër të Mjedjes, gjejmë një përzierjeje temash dhe motivesh që e përcaktojnë përmbajtjen e veprës *Juvenilia*.

Vepra *Juvenilia* fillon me poemthin *Vaji i bylbylit* që në një formë edhe mund të merret si një përcaktues tematik i të gjithë përmbledhjes në fjalë. Me poemthet *Vaji i bylbylit*, *I tretuni* dhe poezitë e tjera mund të konceptohet kjo përmbledhje si një vepër poetike me tematikë atdhetare. *Juvenilia* si përmbledhje me poezi trajton fatin e njeriut të mbajtur nën sundimin si shembull në poemthin *Vaji i bylbyli*, po ashtu fatin e njeriut të mërguar nga gjendja e rëndë shoqërore dhe sociale rasti në poemthin *I tretuni*, që motiv në këtë poemth të Mjedjes, është mjaft i pranishëm në aspektin e trajtimit të fatit të popullit shqiptar.

Me veprën e tij Ndre Mjedja na njofton me gjendjen shoqërore të asaj kohe, si edhe me vuajtjet e popullit, për të cilën nuk mundej të jetë soditës pasiv dhe mos të reagojë apo pasqyrojë në veprat e tij. *Juvenilia* e Mjedjes, si përmbledhje me poezi në konceptin e saj ruan një tematikë të përafërt midis poemthave, poemës, dhe poezive të saj.

P. Gjeci shprehet se vjershat e Juveniljes e tronditin poetin shpirtërisht. Këto vjersha kanë më tepër vlerë psikologjike se poetike.¹⁹

¹⁹ Pashko Gjeçi. Ndre Mjedja, Juvenilja, në Kritika nr. 1, mars 1944

2.2. Poemthi *Vaji i bylbylit* dhe rrethanat shoqërore

Ky poemth i Mjedjes bart në vete një mesazh mjaft të rëndësishëm për lexuesin që njehëresh, poemthi përshkruan gjendjen shoqërore të shoqërisë sonë. Por studiuesi Rexhep Qosja, thekson se: *Vaji i bylbylit, duket si një poemth i shumzërëshme, por në të cilën, të gjithë zërat, nënshtrohen pikënisjes themelore të ndërtimit të saj: bashkëbisedmit ndërmjet bilbilit, si personazh dhe poetit si krijues i saj.*²⁰

Në këtë poemth ka një ndërlidhjeje mjaft të madhe midis figurës së bilbilit si një shpend i izoluar në kafaz, dhe njeriut të robëruar në atdheun e tij, që në këtë rast këtu na del një ndërlidhjeje mjaft e fuqishme midis këtyre personazheve. Në këtë poemth bashkëbisedimi me bilbilin është mjaft i hapur për t'u shfaqur një ndërlidhjeje mjaft e fuqishme krijues - personazh - gjendje shoqërore, ky trënon në këtë poemth funksionon mjaft mirë, për të realizuar ndjenjën shpirtërore të krijuesit. Bota e personazhit në këtë rast është, botë e ndjenjave mjaft të larta dhe fisnike, që kërkon liri, por realiteti është krejt tjetër në aspektin e krijuar të realiteti shoqëror.

*Tek Vaji i bylbylit – për shkak të konotacionit të bylbylit dhe të vetëidentifikimit të vetvetes me të, poeti e nis me bilbilin si figurë dhe e përfundon si vetmi personale.*²¹

Poemthi në fjalë, në pjesën e parë fillon me vargjet në formën pyetësore, që poeti i drejtohet bilbilit, sepse në këtë pjesë shfaqet trajta e dialogut të monologëzuar, për faktin, se subjekti lirik i drejtohet bilbilit, i cili nuk mund të kthen një përgjigje si në vijim:

Po shkrihet bora

Dimni po shkon

Bylbyl i vorfën,

*Pse po gjimon?*²²

Kjo strofë e poemthit paraqet formën e monologut në mënyrën pyetëse, duke iu drejtuar shpendit (bilbilit), për vajtimin e bërë. Vargu i parë, i kësaj strofe, hap rrugën e ndërrimit të stinës; vargu i dytë e fuqizon edhe më tej mendimin; në vargun e tretë jepet figura e bilbilit;

²⁰ Po aty, fq. 448

²¹ Flamur Maloku. *Vaji i Bylbylit, figura në relacion me kodin tematik* në gaz.: Tema, dt. 12.04.2009

²² Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 4

ndërsa në vargun e fundit kemi një pyetje, e cila e esencializon krejt strofën, duke e trajtuar gjendjen e bilbilit si një gjendjeje të rëndë shpirtërore, dhe njëkohësisht kërkon arsyen e kësaj gjendjeje.

Në këtë pjesë të poemthit natyra e poemthit është mjaft e hapur, por njëkohësisht pa ndonjë rezultat të shumë pritur. Te kjo pjesë na shfaqet pamja e ndërrimit të stinëve, që njëherësh e shfaq ndryshimin e natyrës, por dhe e kërkon arsyen e dëshpërimit të bilbilit. Ndërsa në pjesën e dytë të poemthit ndryshon dhe shfaqet realiteti i rënkimit të bilbilit si në vijim:

*Por ty, n'kafaz t'shtrëngueshëm
Ty t'paska ndrye mizori;
E kurr një herë nuk t'nxori
Me t'lëshue ku zemra t'thrret.²³*

Në këtë strofë deklarimi i subjektit lirik përmes vargjeve në fjalë, e shfaq preokupimin e tij, në formë të hapur. Revolta e shfaqur këtu bënë që këto vargje të shfaqin karakterin e armikut ndaj popullit shqiptar nëpër kohë, po ashtu dhe presionin e vazhdueshëm që e bëjnë në popullin tonë. Vargjet e kësaj strofe japin shenjën për një presion që gjithmonë e ka bërë armiku në shoqërinë tonë. Këto vargje simbolizojnë ndalimin e popullit të pafajshëm në trojet e tij, këtu kemi të bëjmë me një realitet të krijuar në vend.

Por studiuesi Sabri Hamiti, e jep një mendim që e përcakton pjesën e dytë të poemthit, në këtë formë: *Gjithë kënga shqipton një racionalizëm të ndërtimit të kërkuar po pa e prekur një shkallë të lartë e rebelimi, prandaj edhe teksti poetik nuk bëhet këngë po mbetet vaj.*²⁴

Në pjesën e tretë, të poemthit gjendja emocionale e subjektit lirik ndryshon, ku tani preokupimi, mërzia dhe vetmia, bëhen më të theksuara, për faktin se të gjitha këto elemente e përcjellin subjektin nëpër kohë.

Elementet e lartpërmendura në pjesën e tretë, janë pjesë e jetës e subjektit lirik, që bart në vete duke u bërë këto elemente gjendje emocionale dhe shpirtërore e tij. Por studiuesi Rexhep Qosja, për poemthin *Vaji i bylbylit* thekson: *Në qoftë se se në pjesën e dytë vetëm sa*

²³ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 5-10

²⁴ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982. f. 5-10.

*paralajmërohet dramaciteti, në pjesën e tretë zhvillohet, zgjerohet dhe shpjegohet më tepër roli simbolizues i bilbilit në poemth.*²⁵

Ky mendim dhe të tjera mendime e përcaktojnë këtë poemth si një poemth që ka një ndërlidhjeje midis poetit dhe atdheut, ku studiuesi Rexhep Qosja, e përcakton në këtë formë: Duke përmendur fjalën atdhe, poeti sikur i zbërthen plotësisht fjalët qëndrore të poemthit: fjalët bilbil dhe kafaz. “*Këtu për herë të parë lexuesit i jepet mundësia të dyshojë në mos bilbili qenka vetë atdheu i tij, që ndihet i robëruar, si në kafaz, nën sundimin shumëshekullor otoman*”.²⁶

Pra, pjesa e tretë e poemthit shpreh krejt hapur gjendjen e subjektit lirik, që atë e preokupon diçka në shpirt. Kurse në pjesën e katërt, të poemthit ndryshon shprehja e emocioneve, duke kujtuar për ditë më të mira që do të vinë si në vazhdim:

Bylbyl, ky shekull or e ças ndrohet:

Bijnë poshtë të neltit, i vogli çohet;

Edhë natyra po don m'u ndrrue:

*Fillo me gëzue.*²⁷

Tashmë këtu dalin dy forca të tjera që e tërheqin njëra - tjetrën, vuajtja në njërën anë që është bërë pjesë e pandashme e jetës, dhe në anën tjetër shpresa që i mban gjallë. Këtu rritet më shumë forca dhe vullneti të gjitha gjërat do të vinë në vendin e duhur, pra, shpresa është ajo që i fut të mendojnë dhe veprojnë për ditë më të mira pavarësisht gjithë kësaj vuajtjeje.

Vetëm kur e lexojmë vargun e fundit që thotë: *Fillo me gëzue*, në secilën strofë të kësaj pjese përveç asaj të fundit që thotë: *Kam për t'u gëzue*. Këtu hetojmë hapur se kemi të bëjmë me shpresë në mënyrë të fuqishme, por dhe në mënyrën urdhërore. Ky varg kaq këmbëngulës të çon vetvetiu në një drejtim tjetër për të cilin gjithmonë po mendohet liria që do të mbizotërojë në atdhe. Pra, mund të themi se vargu i strofës së fundit *Kam për t'u gëzue* simbolizon një shpresë në shpirtin e subjektit lirik në të njëjtën kohë.

²⁵ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 445

²⁶ Po aty, fq. 445

²⁷ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 16

2.3. Largimi dhe vetmia në poemthin *I tretuni*

Ky poemth i Mjedjes pas pomethit paraprak *Vaji i bylbylit* hyn në krijimtarinë e poetit, si një poemth me motive të përafërta me *Vajin e bylbylit*, por që tani te ky poemth simbolizohet vetmia dhe largimi i subjektit lirik, si një problem në jetën shoqërore.

Poemthi *I tretuni* ndahet në disa pjesë apo në ndarje që pothuajse secila pjesë sjell një gjendjeje emocionale të jetës së subjektit lirik.

Në pjesën e parë të poemthit portretizohen momentet e para të largimit të subjektit nga vendlindja, që tani këto momente bëhen aq mallëngjyese për subjektin në fjalë, ku gjithçka tani merr karakterin e mallit dhe dashurisë për vendlindje. Pjesa e parë, i jep një kuptim mjaft domethënës poemthit, sepse këtu përshkruhen momentet e para të largimit nga vendlindja, dhe përshkrimi i vendlindjes si pjesë e pandarë e jetës së subjektit lirik, që e përcjell tani e tutje nëpër kohë. Në këtë pjesë të poemthit mund të themi se jepet mesazhi i githë poemthit në tërësi si në vazhdim:

Lamtu mirë, o mori Shkodrë!

Lamtu mirë, o ti Cukal!

Zhduket Buna nën një kodrë

*Zhduket Drini nën një mal.*²⁸

Strofa që sollëm këtu hap rrugën e një gjendjeje mjaft të rëndë emocionale të subjektit lirik, por që kjo gjendjeje bartet edhe në pjesët tjera të poemthit. Strofa e lartpërmendur e karakterizon gjithë pjesën e parë duke shfaq momentet e para të largimit nga atdheu. Këtu jo vetëm që jepen çastet e largimit, por dhe jepet një pamje dhe përshkrim i vendit, që në këtë rast, ky përshkrim jep mallëngjimin e subjektit lirik nëpër kohë. Por studiuesi Rexhep Qosja, thekson se: *Pjesa e parë e poemthit përshkruan personazhin duke shkuar në mërgim.*²⁹

Pjesa e dytë, e poemthit e jep një gjendjeje tjetër emocionale që e karakterizon vetmia dhe largimi, ku në këtë pjesë tashmë subjekti lirik, vetëm sa ka filluar një jetë të re, dhe në vend

²⁸ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 20

²⁹ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 450

tjetër. Kështu në pjesën e dytë të poemthit jepet mesazhi dhe fillimet e jetës së re, që tani e këndeje e do të jeton në një vend të huaj dhe larg familjes.

Ndryshimi i vendit subjektiv lirik i sjell edhe një gjendjeje mjaft të rëndë emocionale, ku gjithçka është më ndryshe se në vendlindje, ky emocion që e përcjell subjektin ka të bëjë me ndryshimin e vendit jo nga dëshira e tij.

Në këtë pjesë subjekti lirik vendin e huaj e përshkruan si një vend të errët me hekura që të gjitha këto epitete që i jepen vendit të huaj janë epitete të një burgu të zakonshëm, sepse për subjektin lirik ashtu ka tiparet ky vend që e përcjell gjatë gjithë qëndrimit aty. Mos përshtatja dhe ndjenja e hidhërimit e karakterizojnë subjektin si një vend që gjithnjë nuk do të gjen rehatinë e tij. Në këtë pjesë hapet fuqishëm mospajtimi i subjektivit në vend të huaj, që tani ky mospajtim e përcjell atë gjatë. Në vargjet që do të sjellim në vazhdim përshkruhet ky moment mospajtimi si një revolt që e ka kapluar subjektin lirik.

“Ky diell, që këtu shifet

S'a diell i Shqypnisë;

Kjo dritë që këtu njifet,

A fundi i terrsirës.

Nuk flet, jo, shqyptari

*Si ndihet këtu pari”.*³⁰

Ky mohim që shfaqet nga subjekti lirik vjen si një revoltë e brendshme ndaj vendit të huaj, sepse asgjë nuk është e njëjtë si në vendlindje. Pra, vargjet e kësaj strofe simbolizojnë një ndryshim, i cili lind nga dëshpërimi për faktin se vendlindja gjithnjë është më e mira dhe më e bukura që e njeh njeriu.

Ndërsa studiuesi Rexhep Qosja, pjesën e dytë të poemthit e përkufizon me një mendim si në vijim: *Njeriu i vendosur larg të vetve në vise të tjera.*³¹ Nga ky mendim i lartpërmendur mund të konkludojmë se këtu kemi të bëjmë me një njeri që gjithmonë do të qëndrojë larg familjes në vetmi, dhe i tretur në vende të tjera, pra, kjo strofë jep çastet e para të njeriut larg vendlindjes.

³⁰ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, fq. 22

³¹ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 451

Pjesa e tretë, e poemthit *I tretuni* të Mjedjes, fuqizon ndjenjën e të qenurit larg dhe të një pikëllimi mjaft të madh që e kaplon subjektin lirik. Këtu përjetohet një gjendjeje mjaft e rëndë e subjektit, ku tani del gjithçka hapur si: malli, mërzia, vajtimi, etj., kjo pjesë e esencializon vetminë, njeriun e tretur larg, i cili gjendet në një gjendje mjaft të rëndë shpirtërore për vendlindjen dhe të afërmit.

Studiuesi Rexhep Qosja, pjesën e tretë të këtij poemthi e përshkruan në këtë mënyrë: *paraqitet i tretuni, në breg të detit, duke kënduar përmallshëm për vendin e vet.*³²

Pra, në këtë pjesë bota e subjektit është botë e mendimeve të vuajtura, ku gjithçka ka një brengë në vete, që gjithnjë, kjo brengë e tret në kujtime dhe mallëngjime të largëta. Në strofën që do të sjellim këtu do të njihemi me një gjendje të tillë:

*Pshtetun mbi bërryl, kah deti
Kus ' shifet gja, me sy,
T'përlotshëm kqyr, e n'vedi
Duket se do me ndry
Nji send qi mbrend i vëlote
Si gretha o si gjarpj.*³³

Kjo strofë e kësaj pjese e përshkruan të tretunin si një njeri të humbur midis hapësirës, dhe që gjithnjë në kujtime të pa tretura asnjëherë në mendjen e tij. Kjo botë mendimtare e subjektit problemin e vetmisë e rrumbullakëson si një problem që gjithnjë e mbanë në vete subjektin. E gjithë kjo pjesë, subjektin lirik e përshkruan si njeri të tretur diku larg.

Në pjesën e katërt, të poemthit na shfaqet në tërësi malli që tani këtu kemi, një dialog të subjektit lirik, por që tani ka formën e monologut ku i gjithë dialogu i monologëzuar ka një esencë në vete pra, hap zemrën e subjektit për të shpreh mallin dhe njëkohësisht brengën e tij.

Bashkëbisedimi që zhvillohet midis dy subjekteve, pra, subjektit lirik dhe Lejlekut ka trajtën e monologut që gjithnjë subjekti i drejtohet Lejlekut, pra ky i fundit është sikur vetëm e dëgjon, por që nuk i përgjigjet. Për ta elaboruar këtë dialog do të sjellim disa vargje:

³² Po aty, fq. 450

³³ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 24

*Ah ! m'kallxo, kallxo t'vertetën,
A len diell edhe mb'at ane?
A xhixhlojnë, si paras, n't'shkreten
Shqyptarinë e hyj e hanë?
A lulzojnë me lule t'ershme
Mal e fushë si n'kohë t'at-hershme?³⁴*

Vargjet në fjalë mbajnë në vete një dialog, por që dialog në të gjithë strofën ka pyetje të shumta që i drejton subjektit lirik, Lejlekut për të nxjerrë të paktën një përgjigje për vendlindjen. Kjo strofë më shumë është strofë e formës pyetëse, ku kërkohet që të mësohet më shumë për gjendjen e vendlindjes, sepse malli për të e nxit subjektin lirik ta bëjë një gjë të tillë. Dëshira dhe vullneti për të mësuar gjithçka rreth vendlindjes bënë që subjekti lirik të shtrojë një varg mjaft të gjatë të pyetjeve për vendlindjen.

Pjesa e pestë, e poemthit trajton një situatë mjaft të rëndë emocionale ku dëshira e nënës është një dëshirë më e habitur për të birin duke, e ndier aq shumë nevojën për të që ta ketë afër, shprehet aq dhimbshëm që dëshiron më mirë të ishte i vdekur i biri i saj dhe të gjendet në atdhe, se sa i gjallë dhe larg saj.

Në këtë pjesë të poemthit dashuria e nënës për të birin i kalon kufijtë e një dashurie reale, për të shprehur me aq pasion dashurinë e saj, kjo dashuri tashmë bëhet dashuri e një pasioni dhe force mbi natyrore, në momentin që shprehet ajo dashuri më mirë i vdekur në vendlindje, se sa i gjallë në atdhe të huaj. Kjo frazë ka për qëllim që dashuria e nënës për të birin është dashuri mjaft e fuqishme, sepse krijon forcën e jashtëzakonshme ku dëshiron ta sheh të birin të vdekur në atdhe. Pasioni dhe malli i nënës nuk tejkalohet asnjë çast për të birin dhe gjithnjë krijohet një situatë sa e dhimbshme po aq e pa tejkualuar nëpër kohë.

Vargjet në vazhdim krijojnë një situatë mjaft të veçantë në poemthin në fjalë:

*T'kishe dekë ma mir, o i mjerë,
Thotë sa herë,
Afer nanës, gi t'desht e t'ruejti;
T'i kishe mbyll me duer t'mija,*

³⁴ Po aty, fq. 27

*Këtu te shpija,
Njata sy qi mandja shuejti.³⁵*

Këto vargje në këtë pjesë japin shenjën e një dëshire të nënës, që në të vërtetë kjo nuk është dëshirë e qejfit, por një shprehje mjaft e dhimbshme që shfaq nëna për të birin. Në këtë rast bota e mendimeve të nënës, është botë e mbushur me plot dhembje shprehje mjaft të qarta që shpreh ajo për të. Në këtë pjesë gjithnjë është e fuqishme porosia që jep nëna për të birin, me qëllim që t'i shërbejë atdheut në të gjitha aspektet.

Ndërsa studiuesi: Rexhep Qosja, poemthin *I tretuni* e cilëson kështu: *I tretuni sikundër i thotë edhe titulli mjaft shpjegues sado mjaft i shkurtër, zhvillohet tema e mërgimitarit, që e mundon malli për vendlindjen dhe për vendin e vet.*³⁶

2.4. Jeta reale në poemën *Andrra e jetës*

Poema si zhanër letrar përfaqësohet me një ndërtim të saj, ku karakteristik e saj janë lirizmi dhe epizmi që këto dy elemente bëhen bashkë në zhanrin e poemës. Por studiuesi Ali Aliu, zhanrin e poemës e përkufizon në këtë mënyrë: *Poema është një rrëfim liriko - epik pak më i gjatë në vargje. Poeti aq sa rrëfen për një hero, po aq e shkrinë edhe jetën e vet në atë rrëfim. Gjendja shpirtërore e autorit në fakt ndërthuret me atë të heroit.*³⁷

Nëse i referohemi mendimit të lartpërmendur atëherë duhet të kemi parasysh se kemi të bëjmë me një poemë, e cila përfaqëson gjendjen shpirtërore, të shoqërisë sonë. Poema *Andrra e jetës* e Ndre Mjedjes, ndahet në tri pjesë të mëdha: *Trina, Zoga, Lokja*, secila pjesë e kësaj poeme reflekton një motiv në vete e që këto motive tani i japin kuptim poemës në tërësi.

Pjesa e parë e poemës *Trina*, fillon dhe mbaron me përshkrimin e jetës së zakonshme të familjes shqiptare, në këtë pjesë jepet porosia për mënyrën e të jetuarit që kjo mënyrë tashmë në poemë është një realitet shoqëror, pra, ashtu siç na shfaqet jeta në realitet, poema në këtë pjesë e përshkruan. *Këtu në këtë pjesë poema jep, konotacione edhe*

³⁵ Po aty, fq. 29

³⁶ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 450

³⁷ Ali Aliu: *Teoria e letërsisë* - Doracak për nxënësit e arsimit të mesëm, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 138

religjioze, momenti i vdekjes së Trinës, reflekton për një element të përshkrimit të riteve fetare në jetën shqiptare, sepse këtu ky moment tashmë hap një tjetër rrethanë shoqërore, pra, rrethanën e riteve fetare, sepse figura e Zojës, është aq e theksuar dhe e vlerësuar sa që në këtë pjesë mund të themi se ka një element të rëndësishëm të jetës fetare.³⁸

Ndërsa studiuesi Sabri Hamiti, këtë gjendje emocionale e përshkruan në këtë formë: *Vdekja e Trinës, shpalohet ngadalë, në pikën më të ndjeshme, marrëdhënia e këtyre qenieve dhe morali i tyre. Për Loken, si ta pranojë humbjen e së bijës për vete dhe si ta kontrollojë emocionin para bijës tjetër të mitur.*³⁹ Në këtë pjesë gjendja e vdekjes dhe gjendja shpirtërore mjaft e rëndë e personazhit Lokja, i japin një emocion mjaft të madh këtij personazhi në këtë pjesë. Përshkrimi i ambientit dhe vdekja e Trinës, në këtë pjesë janë karakteristikë sepse këto dy elemente e përbëjnë pjesën e parë të poemës *Andrra e jetës*:

*Gurra e lugur veç ushtonte
Si lahutë me këngë kreshnike;
E nder pemë bylbyli këndonte
Valle dansmet e fisnike.*⁴⁰

Vargjet që sollëm këtu, janë vargje që e karakterizojnë ambientin shqiptar në poemën në fjalë, duke përshkruar ambientin me të gjitha bukuritë natyrore që ka natyra, pra, kjo karakteristik e përshkrimit në këtë pjesë zë një vend mjaft të rëndësishëm në këtë pjesë duke i dhënë kësaj pjese një rëndësi të veçantë.

Në këto vargje përshkruhet ambienti, tradita dhe pamje të ndryshme që karakterizojnë ambientin shqiptar. Figura e lahutës dhe kënga kreshnike e simbolizojnë ambientin dhe traditën e lashtë shqiptare. Ndërsa vdekja e Trinës si karakteristikë brenda kësaj pjese i jep një kuptim tjetër pjesës, pra, një kuptim mallëngjyes dhe mjaft kuptim plotë për jetën e rëndë të tyre. Këtu i hasim edhe elementet e frymës së re të realizmit, përshkrimi i jetës reale, me këtë autori e paralajmëron që pason realizmi... Vdekja e Trinës, është një rast mjaft karakteristik sepse këtu vdekja gjithmonë ka konotacion religjioz.

Rri bij se sonte Trinku

³⁸ Anton Nikë Berisha, *Ndrë Mjeda "Andrra e jetës"*, "Shpresa", Prishtinë, 2005.

³⁹ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. XX - XXI

⁴⁰ Po aty, fq. 33.

Po shkon me bujtë te Zoja;

Merrni këto lule e çoja

Se lumes dhunti për të.⁴¹

Këto vargje që simbolizojnë vdekjen e Trinës në këtë pjesë të poemës janë vargje, të cilat motivin e vdekjes në poemë e shfaqin në momentin ku Trina nuk zgjohet prej gjumit, pra, motivi i vdekjes është mbizotërues në këtë pjesë të poemës.

Pjesa e dytë e poemës *Zoga*, për dallim nga e para vjen me një përmbajtje që tashmë jetës dhe normalitetit i kthehet gjithçka, në kuptimin që duhet jetuar normal, pa u ndjerë gjithnjë me peshën e të kaluarës. Në këtë pjesë të poemës kemi një kthesë në kuptimin që nëse i krahasojmë pjesën e parë me të dytën, në këtë të dytën hapet një gjendje tjetër emocionale, pra, fillojnë çastet e para në kërkim të lumturisë, për faktin se tashmë *Zoga* na shfaqet si personazh që në një formë i kthehet lumturia dhe i shtohet dëshira për jetë.

Pjesa e dytë e poemës karakterizohet me një fillim të ri për jetën, sepse tani gjendja emocionale ka kaluar në një fazë tjetër, për të përjetuar moment të tjera në jetë. Në këtë pjesë të poemës karakterizohet dashuria e cila tashmë për *Zogën* është një moment i ri në jetë, ku ky moment shfaqet si në vargjet në vazhdim:

“Herë n'at gjumë tui qeshun dukej,

Si m'u falë herë dorën çote;

Herë përmallshëm n'vedi strukej

*E n'fetyrë gjaku t'tan i vëlonte”.*⁴²

Kjo strofë jep shenjat e para të një ëndrre të dashurisë, që do ta përshkruajnë këtë pjesë mjaft të rëndësishme të poemës sepse kështu në këtë pjesë jeta merr një kahje tjetër, sepse e karakterizon dashuria që e kaplon *Zogën*. Ëndrra portretizon një dëshirë që kërkohet të bëhet realitet, sepse ky përshkrim mund të cilësohet si një realitet që kërkohet të ndodh.

Ndërsa disa strofa në vazhdim jepen portretizimi i djalit dhe kështu mund të aludojmë në një ëndërr të dashurisë brenda poemës në fjalë, që në këtë rast kjo pjesë fillim e mbarim e

⁴¹ Po aty, fq. 38

⁴² Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982. f. 30.

përshkruan dashuria rinore. Vargjet që sjellim këtu janë vargje të cilat do të nisin rrugën e lumturisë si:

*“Del o bij prej shpijes sate,
Del prej t 'vorfenit katund;
Njato plak qi n'zemre pate
Do t 'përcjellin tjetërkund”.*⁴³

Studiuesi Sabri Hamiti, këtë strofë e interpreton në këtë mënyrë: *“Kënga e fundit e Zogës është shkruar si hymn për natyrën, për ngjalljen e saj. Mund të jetë kjo këngë përgjasimi në një shpirt të bartur në lumturi, por me sa duket, Mjedja, vetëdijshëm nuk shkon tutje këtu pret fijen e ëndrrës. Edhe njëherë në këtë këngë të fundit të Zogës shihet se si Mjedja portretizimin e ambientit e shtin në funksion të portretizimit të njeriut dhe ndjenjës së tij”.*⁴⁴

Pjesa e tretë *Lokja* brenda poemës *Andrra e jetës*, shfaqet përsëri një vetmi e nënës pothuajse sikur në pjesën e parë të *Trina* që kemi një gjendje mjaft të rëndë pra, vdekjen e *Trinës*, ndërsa në këtë pjesë shfaqet vetmia e nënës, e cila si duket kjo vetmi tashmë e shoqëron nënën në të gjitha aspektet e jetës. Kjo pjesë karakterizohet me vetminë si një element që gjithnjë e përcjell personazhin duke e bërë atë të vetmuar dhe të mbyllur në vetmi. Këtu personazhi shfaqet më i vetmuar, më pesimist për jetën, me plotë ëndrra dhe dëshira në vete, por që nuk mund t'i realizoj ngase, gjithnjë vetmia i përmbys të gjitha dëshirat e saj.

Këtu poema ka një pikë takimi me pjesën e parë, sepse edhe këtu vdekja ka një rol mjaft të rëndësishëm në jetën e nënës, pra, në pjesën e parë dhe të tretën vdekja simbolizon një mungesë dhe dhembje, kurse në të tretën vdekja kërkohet si një shpëtim i vetëm që mund t'ia lehtësoj dhembjen nënës për të bijën.

*“E n'balkue mbaruene lulet:
Shurdh a'vendi e shpija tutë;
Jo me loken nji e dytë*

⁴³ Po aty, fq. 31

⁴⁴ Po aty, fq. 40-43-XXI

*Neper shpië ma nuk u gjet.*⁴⁵

Kjo strofë e fillon pjesën e tretë, me një përshkrim të shtëpisë që në këtë rast vetëm sa shfaqet nëna e vetme duke u gjetur e vetme në shtëpi.

Kështu fillon kjo pjesë, e cila tani vetëm sa jep shenjat e para të një ndërrimi nga një gjendje emocionale në tjetrën, pra, ky ndërrim krijon një përshkrim tjetër në poemë. Ndërsa në pjesën e dytë të pjesës së tretë jepet thellësia e gjendjes emocionale e nënës brenda pjesës në fjalë, ku tashmë përveç vetmisë dhe pikëllimit të thellë nuk mund të kuptojmë diçka tjetër.

*“U shty vjeshta e krisantemi
Vetun vorreve lulzon;
Landët e pyje gjithë ku kemi,
Tui fry veri po i cungon”.*⁴⁶

Në këtë strofë dhe në tjerat në vijim jepet një pamje për botë të vetmuar të nënës, e që kjo botë tashmë vetëm merr karakterin e një ftohtësie në shpirtin e nënës, duke e ndjerë me aq lodhje këtë vetmi që e ka përcjell nëpër kohë. Kështu përshkruhet ambienti që gjithnjë e më shumë fiton një monoton mjaft të lartë duke treguar për një kohë mjaft të rëndë që po kalon nëna. Ndërsa studiuesi Rexhep Qosja, poemën *Andrra e jetës* të Mjedjes e përshkruan në këtë mënyrë: *Poema Andrra e jetës në vijat e përgjithshme të ndërtimit kompozicional, i shëmbëllen plotësisht ato: se cilit personazh i kushtohet nga një 34 pjesë e poemës.*⁴⁷

Dy elementët femërorë **ëndërr** dhe **jetë** sigurisht që rrokin dy dimensione të ndryshme shqyrtimi. Njëri merret me planin imagjativ, tjetri i referohet konkretësisë. Poema sipas Gjokës *ka domethënie universale se jeta ndërpritet padrejtësisht, se është një ëndërr që mund të jetohet, por ka edhe receptim të përmbysur si: ndërpreje e ëndrrës (Trina), ëndërr e realizuar (Zoga), ndërprerjes ëndërr-zhgjëndërr.*⁴⁸

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty, fq. 46-48

⁴⁷ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 453

⁴⁸ Behar Gjoka. *Botëperceptimi poetik i Mjedës në poemën Andrra e jetës*, në: Mehr Licht! nr. 25. Tiranë, Ideart, 2005, f. 368-374. Cituar nga Edlira Macaj (Tonuzi). *Poetika e Mjedjes dhe Shkolla Jezuite*: Disertacion. Tiranë, 2015, f. 125

Mark Gurakuqi në monografinë e tij mbi veprën e Mjedjes e sheh Andrrën si një poemë të thellë psikologjike me domethënie të rëndësishme filozofike një tablo realiste e gërshetuar me elementë romantikë.⁴⁹

Sipas R. Idrizit kjo poemë ngrihet mbi një konceptim filozofik e trajtohet nën kërkesat e romantizmit.⁵⁰ Ka edhe qëndrime të tjera lidhur me të si p.sh.: ai i P.Topallit, duke e konsideruar Andrrën e jetës si poemë alegoriko politike: Pjetër Topalli³³¹ e sheh poemën si një alegori e fakteve politike të kohës së shkrimit, ku ndihet përçarja gegë-toskë, ku burrat janë burgosur ose internuar, ku bagëtitë nuk ushtojnë se janë grabitur dhe ku kjo treshe personazhesh në jetën e tyre mbart jo vetëm tragjiken por dhe shpresën për të ardhmen. Në tërësi sipas tij kjo poemë është një alegori politike.⁵¹

2.5. Poezia atdhetare e Mjedjes

Ndre Mjedja, në poezinë atdhetare të tij paraqet të kaluarën historike të popullit shqiptar. Në këtë lloj të poezisë Mjedja, e përçon një mesazh mjaft të rëndësishëm te lexuesit, duke përshkruar ngjarje të rëndësishme historike, kështu ky lloj i poezisë së tij na shfaqet si një lloj i poezisë atdhetare, me këtë rast në këto poezi motivi atdhetar është motiv kryesor brenda poezisë.

Në këto poezi Mjedja, gjithnjë ka në qendër të vëmendjes çështjen atdhetare, pothuajse shumica e poezive trajtojnë këtë çështje si: në poezinë *Varri i Skënderbeut, Mahmut Pasha në Mal të Zi, Mustaf Pasha në Babunë*, etj., që të gjitha këto poezi shfaqin një gjendjeje nëpër të cilën ka kaluar populli. Këto poezi në mënyrë të hapur e përshkruajnë gjendjen e luftës që ka ndodh:

*“N'kamb, o Shkodrë, o nan'e dragojve
Le prei grykës i ' martinës, prei çelikut !
Maje t'bjeshkëve, nder shqype, e n'fund t'shtojve*

⁴⁹ Mark Gurakuqi: *Mbi veprën poetike të Mjedës*. Tiranë, Naim Frashëri, 1980, f.154

⁵⁰ Rinush Idrizi. *Ndre Mjedja*. Tiranë, 8 nëntori, 1980

⁵¹ Edlira Macaj (Tonuzi). *Poetika e Mjedjes dhe Shkolla Jezuite*: Disertacion. Tiranë, 2015, f. 119

Poezia *Mahmut Pasha në Mal të Zi*

Në këtë poezi kërkohet një angazhim dhe dhënie e kushtrimit për atdhe, kështu kërkohet të mbrohet atdheu, sepse në këtë rast gjithnjë shfaqet një gjendje e rëndë shoqërore, por që kjo gjendje tashmë kërkon një angazhim më të madh për t'u trajtuar. Poezia e kësaj natyre e shkruar nga Mjedja, është variant i gjendjes nëpër të cilën kanë kaluar gjenerata të tëra. Në këtë lloj të poezisë jepet një mesazh të lexuesi për të kaluarën.

2.6. Figura e bilbilit në poemthin e Mjedjes

Figura e bilbilit në këtë poemth të Mjedjes ka një mision mjaft të rëndësishëm, që me këtë figurë Mjedja, dëshiron ta përçon një mesazh të lexuesi. Në pjesën e parë të poemthit figura e bilbilit, ka rolin e shpendit në kuptimin e parë të tij, kurse në pjesët e tjera ndërron kuptimi dhe misioni i bilbilit në poemth. Figura dhe bota poetike e Mjedjes, në këtë poemth herë e mbulon figurën e bilbilit dhe herë e zbulon, me këtë rast duhet thënë se: herë ia jep kuptimin e drejt bilbilit si shpend si në pjesën e parë dhe herë e mbulon me figurën e metaforës bilbilin që në këtë rast Mjedja, është një mjeshtër i figuracionit, ku gjithnjë luan me këtë në poemthin e tij.

Në këtë poemth të Mjedjes, gjenden figura të ndryshme si: metafora, krahasimi, etj., por mund të themi se me përdorimin e metaforës në këtë poemth Mjedja, ndërton një poemth mjaft estetik në krijimtarinë e tij. Metafora gjithnjë e mbizotëron këtë poemth sepse e gjithë bota poetike në këtë poemth, është e lidhur ngushtë me figurën e bilbilit brenda poemthit.

Nëse i referohemi bilbilit si shpend i lirë që gjithnjë dëshiron të mbetet në liri, atëherë bilbili i Mjedjes, është një bilbil tjetër që gjithnjë paraqitet me një mision ai.

Kur flet për rolin e bilbilit në poemth studiuesi Rexhep Qosja, figurës së bilbilit i jep një kuptim dhe mision mjaft të qartë në poemth: *Megjithëse bëhet fjalë për bilbilin e mbyllur në kafaz, poeti i drejtohet si të ishte një krijesë e ndërgjegjshme domethënë si të ishte njeri.*⁵³

⁵² Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982. f. 22.

⁵³ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 444

Pra, identifikimi i figurës së bilbilit me njeriun e mbyllur dhe gjendja e rëndë shpirtërore që e kaplon bilbilin në këtë rast, identifikohet me njeriun e izoluar që gjithnjë brenga e tij për atdheun e lënë në errësirë është mjaft e madhe.

Personifikim i bilbilit me njeriun në këtë poemth të Mjedjes, është një metafore, e cila gjithnjë e mbështjellë personalitetin e njeriut të zakonshëm dhe intelektualit njëkohësisht që brenda figurës së bilbilit, qëndrojnë dy figura letrare njëkohësisht, qëndron metafora që e mbulon personalitetin e intelektualit dhe të tjerëve dhe figura e krahasimit, që njëherësh bilbili krahasohet me intelektualin që gjithnjë ka në mendje dhe zemër atdheun në radhë të parë, ku e gjithë dhembja shfaqet për gjendjen e atdheut. Pra, nëse flasim për figurën e metaforës në këtë poemth atëherë duhet ta dimë se gjithë poemthi është një metafore në vete.

Metafora mbretëron në këtë poemth, duke u bërë figura kyçe brenda poemthit, por duhet kujtuar se këtë figurë e ndihmon edhe figura tjetër ajo e krahasimit që gjithnjë është i pranishëm në këtë poemth si në vargjet në vazhdim:

“Gjama jote a porsi ankimi

I nji fëmiës që vetun mbet:

Gjama jote a si shungullimi

*I nji t’ zezës qi gja se pret”.*⁵⁴

2.7. Njeriu i humbur dhe figuracioni poetik

Poemthi *I tretuni* i Mjedjes në strukturën e tij shfaq një problem të kahmotshëm të popullit tonë. Por ajo çka e karakterizon këtë poemth padyshim se është figuracioni poetik që mban në strukturën e tij, ku me këtë figuracion hapet bota poetike brenda poemthit. Ky poemth fillon me figurën e metaforës për të përshkruar një gjendje mjaft të rëndë shoqërore, dhe kjo gjendje tani bëhet e zakonshme në aspektin shoqëror duke u përshkruar me figurën e metaforës, sepse këtu kjo gjendje shoqërore në lexim të parë të tekstit shihet si një kohë me shi dhe stuhi, por gjithë këto vargje përgjasojnë me gjendjen e luftës nëpër të cilën kalon vendi.

⁵⁴ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja Prishtinë, 1982, fq. 12

Pra, poemthi *I tretuni* bart në vete edhe figuracione të tjera poetike, si p.sh. alegorinë dhe ambiguitetin, pra, në këtë poemth gjithnjë gjejmë figuracion të ndryshëm, sepse Mjedja gjithnjë ka përdorur për të ndërtuar këtë poemth për të provuar direkt me tekstin do të sjellim disa vargje që janë shembulli i shprehjes përmes alegorisë si:

*Me shi pshtjellun acarija
Përmbi bjeshkë po shungullon;
E prei maleve stuhija
Ujët e detit e përvëlon.⁵⁵*

Kështu në këto vargje shprehet Mjedja, duke përdorur figurën e alegorisë, që paraqet një gjendje të rëndë nëpër të cilën po kalon populli, këtu figura e alegorisë gjithnjë është në funksion të bartjes së kuptimit të vërtetë, por në pamundësi për të thënë atë realitet. Ndërsa studiuesi Rexhep Qosja për poemthin *I tretuni* thekson se: *Te kjo poemë Mjedja, i vë ndjenjat në shërbim të mendimit, duke e shquar ashtu domethënien e saj të përgjithshme.⁵⁶*

*“O lejlek o shpend udhtar
Qi prej s largu je tu i mbrrië,
Nalu ' j herë njiket shkretië
Nji fjalë t' vetme due me t' vetë
O lejlek, o shpend i shkret”.⁵⁷*

Këtu figura e ambiguitetit është më se e pranishme sepse ambiguiteti, e përshkruan këtë strofë sikur një gjendje mjaft të rëndë shpirtërore sepse këtu preket gjithnjë mendimi mbi vendlindjen. Në këto vargje apostrofohen shumë mendime të subjektit lirik që gjithë i shfaqen në kokë për vendin e tij, kurse ky monolog i zhvilluar e nxit subjektin që të mendoj më shumë për vendin, sepse këtu vargjet japin konotacione për ta forcuar mendimin sepse gjithnjë mendimet e tij janë mendime të një malli të pashuar nëpër kohë.

⁵⁵ Po aty, fq. 19

⁵⁶ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 452

⁵⁷ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 26

2.8. Figuracioni në poemën *Andrra e jetës*

Në pjesën e parë të poemës *Andrra e jetës* të Mjedjes, përshkruhet ambienti shqiptar me epitete nga me të ndryshme, sepse jepet jeta tipike shqiptare, ku të gjitha përshkrimet i japin një pamje mjaft të qartë ambientit shqiptar. Poema *Andrra e jetës* me figuracionin e saj jep jetën tipike të familjes shqiptare, duke e përshkruar ambientin dhe duke i personifikuar personazhet nëpër poemë.

Në pjesën e parë përveç përshkrimit të ambientit rural që është një karakteristikë në poezinë e Mjedjes, aty jepet dhe aktiviteti i anëtarëve të familjes. Në këtë pjesë të poemës të emëruar Trina është pjesë e mbështjellur me epitete të shumta për ambientin dhe vendlindjes si në strofën në vazhdim:

*“Molla t'kputuna nji degë,
Dy qershija lidhë n ' nji rrfanë,
Ku fillojnë kufijtë e Geget,
Rrijnë dy çika me ni nanë”⁵⁸*

Kështu jepet ambienti shqiptar, duke e përshkruar me një mori epitetesh nga stina e pranverës për të dhënë një pamje të jetës shqiptare, që gjithnjë ka një frymëzim të veçantë etj. Në këtë strofë jo vetëm që jepet përshkrimi i ambientit shqiptar, por dhe këtë strofë gjithnjë shfaqet një tendencë e kufirit gegë që kjo tendencë, nuk është ndonjë ndarje, por një afirmim edhe më shumë një figurë e ambientit për t'i dhënë një kuptim kësaj strofës dhe pjesës në përgjithësi.

Në pjesën e dytë të kësaj pjese ndjehet dhembja apo sëmundja e personazhit që njëherësh jep shenjën apo paralajmëron vdekjen. Pra, poezia e dytë parashton poezinë e tretë, te Trina kështu në këtë rast njihemi me një dhembje shpirtërore të nënës për të bijën Trina. *Nëse i referohemi kësaj poezie brenda pjesës Trina, do të njihemi me një shkallëzim të situatës dhe dhënies së rezultatit në poezinë e tretë të kësaj pjese. Te poezia e dytë vetëm e shfaq gjendjen duke mos dhënë ndonjë rezultat. Ndërsa studiuesi Zejnullah Rrahmani, në këtë rast figurën e Zojës e përshkruan përmes epitetit Zonjë e fatit ku e poetizon vdekjen.⁵⁹*

⁵⁸ Po aty, fq. 35

⁵⁹ Zejnullah Rrahmani: *Arti i poezisë*, Faik Konica, Prishtinë, 2001, fq. 127

Kështu paraqitet figura e vdekjes përmes personifikimit që e realizon vdekjen e Trinës, si një rast mjaft i rëndë, por kur personifikohet vdekja, figura e Zojës merr kuptimin e *Zonjës së rëndë* dhe gjithçka që vjen prej saj është e pranishme. Në pjesën e dytë *Zoga* e përshkruan figura e rëndë e metaforës, sepse e gjithë pamja dhe përshkrimi i vendit jep shenjën e lulëzimit të dashurisë së Zogës, sepse në këtë rast *Zoga* ka një fat tjetër domethënë fati i Zogës, është fat i lumtur apo i kundërt me fatin e të parës. Njëra bëhet simbol i vdekjes derisa tjetra simbol i jetës që e përcjell Zogën gjatë gjithë pjesës së dytë si në vazhdim:

*“Ndoshta po avitet nji djalë i ri
I holl e i gjatë porsì selvi,
Me rryp rreth brezit me ni gjashtore
E'j kacatore”.*⁶⁰

Studiuesi Sabri Hamiti, këto vargje i përshkruan në këtë mënyrë: *Pra, leximi dhe shkrimi i tektit, siç ndodh gjithnjë me tekstet të dhëna vetëm ndërmjet shenjave themelore për t'u plotësuar me një imagjinatë leximi.*⁶¹

Ndërsa vargjet që do të sjellim këtu janë vargje që e përmbushin dashurinë e Zogës duke marrë dhe miratimin e të tjerëve:

*“Del, o bij prej shpijes sate,
Del, preit ' vorfenit katund;
Njato flak qi n'zembrën pate
Do t ' përcjellin tjetërkund”.*⁶²

Në këto vargje shfaqet hapur miratimi duke u bërë njëherësh dhe detyrë për Zogën, sepse, kërkohet që të del *Zoga* prej një vendi në tjetrin për dëshirën e dashurisë. Ndërsa vargu i tretë në këtë strofë është një varg i mbushur me figurën e metaforës, ku mund të aludojmë për një gjendje nëpër, të cilën ka kaluar *Zoga*, dhe mund të kërkojmë se në këtë varg shprehet flaka e dashurisë që bart në vete personazhin.

Pjesa e tretë e poemës *Andrra e jetës* e titulluar *Lokja* në radhë të parë përshkruhet nga figura e simbolit duke dhënë pamjen e një vendi të shkretë që askush nuk e viziton dhe

⁶⁰ Po aty, fq. 127

⁶¹ Sabri Hamiti: *Letërsia filobiblike - letërsia romantike*, Faik Konica, Prishtinë, 2002, fq. 43

⁶² Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982. f. 12.

askush nuk e mirëmban në aspektin e rregullimit që i bëhet shtëpisë. Pra, kjo pjesë përshkruhet me një zymti që mbizotëron tashmë në shtëpi dhe përpos nënës askush nuk gjendet brenda në shtëpi tani e tutje. Në këtë pjesë mbizotëron vetmia si një gjendje emocionale, që e shoqëron personazhin gjatë gjithë kohës. Kështu ky dëshpërim dhe pikëllim i nënës bëhet i vazhdueshëm dhe pjesë e pandarë e jetës së saj:

*“Kish mbajtë zjermin ndez mbi vatrë,
Ja kish njomë njat buk e mjera”⁶³*

Kështu vargjet që sollëm këtu janë simbol i një vetmie të thellë në të cilën gjendet nëna, ku ky përshkrim flet për një gjendje emocionale mjaft të rëndë. Pra, fjalët zjarr, vatër, bukë, etj., janë figura që simbolizojnë ambientin ku jeton nëna nëpër kohë. Kështu jepet jeta e nënës në pjesën e tretë, ka dëshpërimin dhe vetminë, si dy elemente që e përcjellin personazhin.

Ndërsa në poezinë e dytë të kësaj pjese jepet mesazhi i qartë i nënës përmes figurës së alegorisë:

*Përmbi plakën krahër i uli,
E ngrykt’ shuemen e shtrëngo; j;
Buzët t’ shpulpueme n’ ball ja nguli;
U ndal drita e ajo mbaroj.⁶⁴*

Për këtë strofë studiuesi Zejnullah Rrahmani, shprehet në këtë mënyrë: *Alegoria është zonja që ngadalë të shtrohet mbi kuptimin e poezisë duke ndërtuar esencën e poezisë, semantikën e saj, gjithë botën e një vjershe.*⁶⁵

2.9. Hiperbola në poezinë e Mjedjes

Poezia atdhetare e Mjedjes, në strukturën e saj karakterizohet me figurën e hiperbolës si një tërësi ndër figurat më të pranishme në poezinë atdhetare në përgjithësi. Poezitë tjera të Mjedjes, figurën e hiperbolës e kanë që të gjitha si një tërësi ndër figurat kryesore në

⁶³ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982. f. 11.

⁶⁴ Po aty

⁶⁵ Zejnullah Rrahmani: *Arti i poezisë*, Faik Konica, Prishtinë, 2001, fq. 103

strukturën e tyre, për të paraqitur këtë shembull do të sjellim disa vargje që janë të ndërtuar me figurën e hiperbolës si në vazhdim:

*“N'kamb'o Shkodrë, o nan e dragojve
Le prei grykës t' martinës, prei çelikut!
Maje bjeshke ndër shqype en' fund t shtojve
Ku buçori shqyptar avullon”.*⁶⁶

Në poezinë *Mahmut Pasha në Mal të Zi* figura e hiperbolës është mjaft e pranishme e sidomos në këtë strofe ku fjalët grykë e martinës, çelik, shqipe, drague etj., janë të mbështjella me figurën e hiperbolës sepse këto fjalë në këtë strofë marrin funksionin e trimërisë si një forcë shtytëse për popullin shqiptar. Kjo strofë mund të interpretohet si një parullë për mobilizim të gjithë popullit kundër armikut kështu jepet kjo poezi. Mision i saj është një organizim i popullit për t'u bashkuar kundër armikut kështu dhe figura e hiperbolës, që është përdorur këtu ka një mision të tillë.

Pra, nëse iu referohemi edhe poezive të tjerave me tematikë të njëjtë të Mjedjes, atëherë do të mjaftohem edhe më shumë me këtë figurë mjaft të përhapur në poezinë e Mjedjes, që ky poet gjithnjë në poezinë e tij atdhetare e ka të pranishme këtë figurë duke e karakterizuar me shumë shprehje gjuhësore që njëherë vetëm se më shumë e pasuron poezinë e tij atdhetare me përdorimin e figurës së hiperbolës në poezi.

Figura e hiperbolës zmadhimit me qëllime të caktuara është e pranishme në disa poezi të tij si: *Mahmut Pasha në Mal të Zi, Vorri i Skënderbeut, Mustafë Pasha në Babunë* etj., pra, gjithnjë figura e hiperbolës është e pranishme te ky poet.

⁶⁶ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 58

KAPITULLI III

Historiku i sonetit shqip

Soneti apo tingëllima siç quhet ndryshe, përbën një lloj të veçantë të poezisë në vete, duke pasur disa specifika në strukturën e tij. Historiku i zhvillimit të sonetit shqip, ka një periudhë të vonshme të zhvillimit të tij, njëjtë sikurse edhe gjinitë e tjera letrare në letërsinë shqipe, njashtu edhe ky lloj i poezisë i ka vonesat e tij, duke marrë parasysh krijimin e këtij lloji të poezisë në letërsinë botërore. Sa i përket historikut të zhvillimit të kësaj poezie, shohim se fillet e shkrimit të kësaj lloj poezie lidhen me një zhvillim të shkrimit më herët se Mjedja, që e shkruan. Pra, në letërsinë shqipe, ky lloj i poezisë është shkruar qysh në letërsinë e vjetër shqipe, e shkruar nga autori Nikollë Keta.

Pra, sipas studiuesit Ali Aliu, ky lloj i poezisë ka një zhvillim të këtillë: *kjo lloj poezie në fakt është një vjershë në vete. Në letërsinë e përgjithshme është i njohur soneti që ka përdorur poeti i madh italian, Petrarka ku njihet dhe si soneti petrarkian. Kurse në poezinë tonë të traditës e ka përdorur me shumë sukses Mjedja, në poemat sonetike: Lirija, Lissus, dhe Scodra.*⁶⁷

Sipas studiuesit Milazim Krasniqi shfaqja e sonetit të parë shqip është me një vonesë të njëjtë sikurse e gjinive të tjera të letërsisë si në vazhdim:” *Poezia shqipe u shfaq me vonesë të madhe, dhe fillimisht brenda librave të përkthyer fetarë në gjuhën shqipe. Poezitë e Budit dhe Bogdanit u botuan vetëm në shek XVII. Rrjedhimisht, edhe shfaqja e sonetit të parë në gjuhën shqipe në vitin 1777, është vetëm njëri nga rastet e shfaqjeve të tilla me vonesë tepër të madhe*”.⁶⁸

Soneti si lloj i poezisë gjithnjë në strukturën e tij paraqet një specifikë në vete për nga struktura e tij, duke iu nënshtruar një rregulli të caktuar që gjithmonë atij rregullit duhet t'i përmbahemi me një përpikmëri të skajshme gjatë shkrimit të sonetit, pra, duke iu përshtatur në plotëni rregullit bazë dy strofave katrena (katër vargjëshe) dhe dy strofave

⁶⁷ Ali Aliu: *Teoria e letërsisë - doracak për nxënësit e arsimit të mesëm*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 91

⁶⁸ Milazim Krasniqi: *Soneti në poezinë shqipe*. PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005, fq. 27

tjera tercina (tre vargjëshe), pa iu shkëputur edhe njëmbëdhjetërokëshit në çdo varg, si dhe një harmonie të vazhdueshme të rimës.

Pra, soneti si lloj i poezisë me të gjitha këto specifika të tij, paraqet një lloj të veçantë në strukturën e poezisë në përgjithësi. Kurse sonetet e Mjedjes i plotësojnë këto kritere në të gjitha aspektet duke iu nënshtruar rregullave në të gjitha pikat që e përcaktojnë rregullat e sonetit.

3.1. Soneti Lirija sonet i lirisë së atdheut

Kjo poemë sonetike e Mjedjes, e ndërtuar me temën dhe motivin atdhetar, bart në vete një porosi mjaft të qartë të lexuesi se kujt i drejtohet poeti me këtë poemë sonetike. Bota poetike që mbizotëron në këtë poemë sonetike është një botë poetike mjaft e hapur që gjithnjë në qendër të vëmendjes e ka atdheun dhe lirinë e tij, kështu në këtë rast këtu hapet bota e mendimeve dhe ndjenjat e poetit që shfaq dashurinë për atdheun.

Poema sonetike *Lirija* ndahet në gjashtë pjesë, që të gjitha pjesët kanë një unifikim në vete, dhe ky unifikim ndihmon që kjo poemë sonetike të ketë një strukturë mjaft unike. Pjesa e parë, e poemës sonetike fillon dhe mbaron me një varg pyetjesh retorike që gjithnjë qëllimi i subjektit lirik është një preokupim në vete, që ky preokupim fillon të shfaqet tani e këndeje. Kjo pjesë është pjesa ku gjithnjë bëhen pyetje dhe nuk jepen përgjigje, pra, në këtë pjesë na shfaqen shumë pyetje retorike që këto pyetje kërkojnë përgjigje, por nuk ndodh një gjë e tillë, me këtë rast vetëm sa shtohen kërkesat e subjektit lirik ndaj gjendjes së atdheut.

Zëri i subjektit lirik është zë i fuqishëm që ka në mendjen e tij, një numër mjaft të madh të pyetjeve për gjendjen e atdheut. Kjo pjesë e pyetjeve të vazhdueshme të natyrës retorike jo vetëm që e hap rrugën e kërkesave të vazhdueshme të subjektit lirik, por dhe shpreh gjendjen emocionale të subjektit që po e preokupon në vete.

*A keni ndie, kah flutroni
Nëpër shkrepë, me ushtue kanga e sajë,
A keni ndie një kangë të pa travajë?*

Kjo strofë dhe të tjerat të kësaj pjese, shfaqin dëshirën e subjektit që gjithnjë ka në brendësinë e tij, duke bërë pyetje të ndryshme për gjendjen që po mbretëron në atdhe, ku në secilin varg shtrohen pyetje të ndryshme që lidhen me gjendjen shoqërore. Në këto vargje zëri i subjektit është një zë i unit të brendshëm që buron nga dëshira dhe vullneti për ta parë atdheun në një gjendje tjetër, pra, në liri të plotë.

Vargjet e lartpërmendura shprehin dëshirën dhe vullnetin e subjektit se si dëshiron ta shoh atdheun, por mbi të gjitha kjo pjesë ka për qëllim zbulimin e gjendjes së atdheut se si është në të vërtetë. Vetëm në vargun e fundit të kësaj strofe shohim një insistim të subjektit se çka dëshiron të mësojë më shumë për atdheun.

Ndërsa studiuesi Milazim Krasniqi, për poemën sonetike *Lirija* sjell një mendim si në vazhdim: *“Thirrja e poetit që shqipja të sogjetojë lirinë e të shoh ku e ka amën ajo liri, është një thirrje e racionalizuar në çaste dhe krijon kuadrin që të shihet më larg nga gjendja aktuale, të krijohet hallka e komunikimit me lirinë si vlerë universal”*.⁷⁰

Pjesa e dytë, e kësaj poeme vjen më ndryshe sepse tashmë thirrja për mbrojtje nga armiku sa vjen dhe shtohet duke pasur parasysh këtë fakt, tashmë nuk kemi vetëm pyetjeje të ndryshme si në pjesën e parë, por tashmë bëhet thirrje për të lanë gjithçka nga pasuria dhe për të shkuar në mbrojtje të atdheut. Pra, kur kemi të bëjmë me shkrimin e poezisë do të theksojmë një mendim të Jorge Luis Borgesit, rreth shkrimit të poezisë si në vazhdim: *sipas Borgesit, kryesorja është që ne të mendojmë se fjalët i përkasin korrespondojnë me emocionet e shkrimtarit*.⁷¹

Ky mendim i Borgesit lidhet me këtë pjesë të poemës sonetike të Mjedjes, duke pasur parasysh se në këtë pjesë subjekti lirik flet me një emocion mjaft të lartë, duke bërë thirrje të vazhdueshme për angazhim më të madh të popullit për t'i dalë në ndihmë atdheut. Për të parë më afër këtë ndjenjë të thirrjes në këtë pjesë të poemës do të sjellim disa vargje:

“Çonju sherbtorët e tokës, leni te shpia

Shejtit e vangat e për gjysë, o trima,

⁶⁹ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 121

⁷⁰ Milazim Krasniqi: *Soneti në poezinë shqipe*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005, fq. 99

⁷¹ Jorge Luis Borges: *Kjo mjeshtri e poezisë*, përktheu: Arsim Canolli, Ceneus, Prishtinë, 2010, fq. 94

*Leni parmendat rrokni pushkët vetima
Ju duk për së lergu, e qe po vjen lirija”;*⁷²

Këto vargje të kësaj strofe shprehin hapur thirrjen e zërit të subjektit lirik që njëherësh kjo thirrje bëhet kushtrim në vete që gjithnjë ka për qëllim që të bëhet një thirrje e vazhdueshme në mbrojtje të atdheut.

Pjesa e tretë, e poemës *Lirija* shpreh një ndjenjë tjetër emocionale, e cila ndjenjë krijon një pamje tjetër ku tashmë përveç që parafytyrohet liria, gjithashtu bëhet një falënderim për shtetet që mundësojnë lirinë. Në këtë pjesë e cila krijon ndjenjën e lirisë, zhvillon pamje në dy aspekte; në aspektin e parë hiqet nga mendja robëria se nuk do të ketë më vuajtje dhe presion, në aspektin e dytë liria shihet si një përjetim mjaft i mirë. Vargjet që do të sjellim këtu janë vargje që gjithnjë e projektojnë lirinë e atdheut si nëpër të gjitha vendet e tjera.

*“U kputne hekrat, e lirin malcori,
Lirin deti kumbon e ja siell bregut;
U njom toka për mall me brohorië
E mbi flamuj të zotnuem ndejti luani”.*⁷³

Vargjet e cekura japin shenjën e një atmosfere mjaft të qartë se liria që e përjetojnë populli është një ndjenjë e bukur, duke u bërë ndryshim prej një gjendjeje të zyrtë që ishte deri tani, dhe tashmë e këndej kjo gjendjeje merr një kahje tjetër. Në këtë pjesë liria dhe robëria janë dy gjendjeje emocionale që e përfaqësojnë gjendjen e popullit në përgjithësi, me këtë rast liria e kërkuar dhe robëria si opsion i pa dëshiruar janë pjesë e pandarë e jetës së përditshme.

Në pjesën e katërt projektohet liria e fituar me mjaft mund dhe sakrificë, për të ardhur deri te synimi i popullit që në këtë rast është liria. Në këtë pjesë tashmë liria jo vetëm që bëhet kërkesë e vazhdueshme e popullit, por dhe ndjenjë e thellë që e përjeton populli, sepse në këtë pjesë gjithnjë shfaqet ëndrra e kamotshme për liri, që kjo ëndërr e lirisë thyen shumë tabu.

⁷² Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 15

⁷³ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq.121

Vetëm dy vargjet që do të sjellim japin shenjën e gëzimit të pakufishëm që mbretëron në shpirtin e popullit.

“E ndjeu toka njatë shend e u gëzue

Si fëmija

*Nder fush'e male mungulloi lirija”.*⁷⁴

Në këto vargje shfaqet gëzimi dhe hareja për lirinë që e ndjenjë populli. Këtu liria si kërkesë e kamotshme simbolizon një kohë mjaft të vështirë nëpër të cilën ka kaluar populli. Jeta që zhvillohet në trojet shqiptare është një jetë e rëndë dhe pa një të ardhme të ndritur dhe të sigurt, kështu me këtë rast liria është gjithnjë një kërkesë e rëndësishme që gjithmonë për të sakrifikohen gjeneratat në vazhdimësi.

Pjesa e pestë, e poemës sonetike *Lirija*, shfaq në mënyrë deklarative presionin e dhunshëm që i bëhet popullit nëpër kohë. Në këtë pjesë trajtohet me hapur fati i rëndë i popullit për ditët nëpër, të cilat po kalon populli shqiptar, si pasojë e pushtimit të vendit, pjesa e pestë, e poemës sonetike *Lirija*, shfaq në mënyrë deklarative presionin e ku shprehet gjendja aktuale dhe njëherësh pa fuqia për të ndryshuar atë gjendje që po mbretëron në vend.

Vargjet e kësaj pjese të poemës simbolizojnë robërinë që e ka kapluar popullin, në një formë kështu atdheu gjendet para një kolapsi të përgjithshëm, sepse pesimizmi i shfaqur në vargjet e kësaj pjese bëjnë që gjithnjë të kujtojmë një gjendje të rëndë shoqërore. Disa vargje të poemës në fjalë, shfaqen hapur shenjat të realitetit të krijuar si në vazhdim:

“Lirin e keni ju: na hekra kemi.

Na terr e niegull deri në dit ma të vona;

Na pa emër kërkund, pa atdhe, na jemi

*Sherbtorët e të huejvet neper vendet tona”.*⁷⁵

Vargu i parë dhe të tjerët në vazhdim janë vargje simbolizuese ndaj realitetit në përgjithësi. Në vargun e parë jepet e tërë esenca e kësaj pjese, sepse këtu subjekti lirik, shpreh një pakënaqësi të dukshme, që në këtë varg gjithnjë, jepet esenca e tërë e kësaj pjese të poemës *Lirija*, duke mos lënë asnjë dyshim te lexuesi se asnjë se për çka po bëhet fjalë

⁷⁴ Po aty, fq.122

⁷⁵ Po aty, fq. 125

brenda këtyre vargjeve, këto vargje gjithnjë shprehin dhembjen për gjendjen shoqërore. Por sipas studiuesit Rexhep Qosja, poema sonetike *Lirija*, është poemë që përshkruan fund e krye prej ndjenjash të tendosura dhe prej zërit të ngritur.⁷⁶Mendimi i lartpërmendur përshkruan tërë poemën *Lirija*, të Mjedës, duke pasqyruar tonin e lartë të zërit, të subjektit lirik për gjendjen aktuale shoqërore që mbretëron në vend.

Me këtë rast bota e mendimeve e subjektit lirik, është e lidhur ngushtë me gjendjen shoqërore ku gjatë gjithë poemës në fjalë, kemi një tonë të tillë, të zërit që shfaqet nga ana e subjektit lirik nëpër kohë. Që në vargjet e para të kësaj pjese esencializohet gjendja shoqërore, ku simbolizon gjithë realitetin, dhe gjithnjë duke shfaqur mospajtimin me një realitet të tillë, ku bëhet zëri i fuqishëm kundër një gjendjeje që e ka kapluar vendin.

Në këtë pjesë të poemës, hapet bota e mendimeve të subjektit, në realitet hapet që në vargjet e para të kësaj pjese shfaqet kundërshtimi dhe kërkimi drejt një realiteti të ri, që tashmë këtu bëhet një kërkesë e brendshme e subjektit, por që fillon dhe shfaqet në shoqëri.

Kurse pjesa e gjashtë e poemës sonetike, *Lirija*, që njëherësh është pjesa e fundit e kësaj poeme, si duket hap rrugën e shpresës te populli shqiptar, për një të ardhme më të mirë. Në këtë pjesë të poemës ndjenja e subjektit lirik merr një kahje tjetër, do të thotë në këtë rast subjekti lirik, pushtohet nga shpresa për ditë më të mira që do të vinë, dhe njëherësh dhe rezistencës që i ka përballuar populli.

Këtu simbolizohen dy gjendje shoqërore robërinë e përjetuar dhe lirinë e ëndërruar, që e karakterizojnë mendimin e subjektit brenda kësaj pjese. Kjo pjesë e poemës ka një përzierje ndjenjash dhe mendimesh brenda vetes, duke pasur parasysh dy gjendje emocionale mjaft karakteristike, duke i dhënë kësaj pjese kuptim të qartë. Esenca e gjithë kësaj pjese, pasqyron karakterin dhe vullnetin e popullit, për të mos u gëzuar asnjëherë përballë vështirësive që iu kanosen.

⁷⁶ Rexhep Qosja: *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 464.

3.2. Udhëtimi në kohë në poemën sonetike *Lissus*

Poema sonetike *Lissus* e Mjedës përbëhet prej disa pjesëve, këto pjesë përbëjnë tërësinë poetike të poemës *Lissus*. Poema *Lissus*, shfaq disa momente mjaft të rëndësishme, fillon me përshkrimin e bukurive natyrore që përbën pjesën e parë të kësaj poeme, për të vazhduar me disa momente të tjera po aq të rëndësishme për atdheun.

Pjesa e parë e kësaj poeme sonetike fillon me përshkrimin e bukurive natyrore dhe atyre njerëzore, duke bërë një përshkrim mjaft të bukur me qëllim që ta paraqesë sa më bukur atdheun. Esenca e kësaj pjese, kontribuon në shfaqjen e bukurive që plotësojnë bukurinë e atdheut, në masë mjaft të gjerë. Ndërsa, sa i përket kësaj pjese studiuesi Sabri Hamit, i cili thekson se: *kjo mënyrë e rrëfimit mitik, ku autori fshehet fiktivisht në të shumtën e rasteve mbas tekstit të vet dhe e bënë atë histori, në rastet e tjera shpërthen haptas me një thirrje, apo një kërkesë identifikuese.*⁷⁷

Mendimi i lartpërmendur e përkufizon këtë pjesë si një pjesë që gjithnjë ka për qëllim poeti të realizojë atë kërkesë të brendshme shpirtërore, për dashurinë ndaj atdheut. Në këtë pjesë gjithnjë qëllimi kryesor është që të jepen bukurit natyrore të atdheut, vargjet në vazhdim që do të sjellim janë një shembull i mirë për një përshkrim në vazhdim.

*Nëpër kodra të stolisuna me vneshta
Ku vilet arit xhinxhillojshin në diell,
E rrotull fushën tui kaditun, prilli
Edhe lulzote kur kish himun vjeshta.*⁷⁸

Lulëzimi në stinën e vjeshtës është një metaforë në vete që simbolizon bukurinë dhe lumturinë edhe në stinën e vjeshtës, këtu kemi të bëjmë me një jetë të lumtur të ilirëve dhe në anën tjetër, lumturia dhe bukuria eksiton në atdhe. Studiuesi Milazim Krasniqi, për këtë poemë sonetike për pjesën e parë thekson: *“shpalos një përshkrim të jashtëzakonshëm të ambientit të qetë e të begatë të botës ilire, ku edhe stina përshkruhet si e përjetshme në*

⁷⁷ Sabri Hamiti: *Letërsia filobiblike - letërsia romantike*, Faik Konica, Prishtinë, 2002, fq. 407

⁷⁸ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 129-51

bukurinë dhe begatinë e atij ambient".⁷⁹ Ky peizazh dhe përshkrim që i bëhet vendit nga ana e poetit, përbën një forcë krijuese duke krijuar një ambient sa piktoral po aq dhe të begatë.

Pjesa e dytë e kësaj poeme përbën elementin e përshkrimit të bukurive natyrore, dhe po ashtu duke përshkruar kontributin e popullit për mbrojtjen e atdheut. Nëse i referohemi edhe më tej elementit të mbrojtjes së atdheut, atëherë do të shohim se në këtë pjesë gjithnjë është i pranishëm ky element me gjithë përkushtimin e poetit.

Ndërlidhjet mitologjike siç janë figurat e Zanave dhe e ilirëve, në këtë pjesë menjëherë merr karakterin historik, që duhet ta njohim rolin e tyre në mbrojtje të atdheut, me një përkushtim të vazhdueshëm siç është roli i këtyre dy figurave lirike brenda kësaj pjese.

Pjesa e tretë e poemës po ashtu ka për qëllim të shfaqë bukurinë dhe madhështinë e qytetit të Lezhës, si një qytet mjaft karakteristik me bukuritë e tij, por njëkohësisht dhe mjaft i rëndësishëm i së kaluarës sonë kombëtare, që njëherësh mund të quhet qytet i qëndresës dhe krenarisë kombëtare me një të kaluar të lavdishme të paraardhësve tonë ilirëve. Këtu jo vetëm që jepet bukuria e këtij qyteti, por e gjithë simbolika e kësaj bukurie lidhet me karakterin dhe vendosmërinë e ilirëve ndaj atdheut, ku poeti merr shembull qytetin e Lezhës, duke pasur një domethënie të veçantë pasi me të lidhet krejt e kaluara jonë kombëtare me këtë qytet.

Bukuria dhe madhështia e këtij qytetit, shprehet në vargjet duke bërë një përshkrim mjaft të qartë sepse forca krijuese e poetit këtë qytet e shndërron në një qytet sa historik po aq antik, duke kurorëzuar dy elemente brenda kësaj pjese: elementi bukurisë dhe atë të krenarisë atdhetare.

Pjesa e katërt e poemës sonetike *Lissus*, fillim dhe mbarim ka për qëllim të paraqesë lavdinë dhe krenarinë kombëtare, që këta dy elemente e kanë përcjellë mjaft gjatë popullin tonë. Në këtë pjesë thuret lavdi dhe krenaria për bijtë shqiptarë, të cilët e mbrojtën atdheun në ditë më të vështira, lavdi që iu thuret paraardhësve tonë ilirëve, autori ka për synim që të jepet një porosi si gjithnjë. Atdheu, ka pasur bijë që i dalin në ndihmë. Vargjet që do të sjellim në vazhdim kanë një mision në vete se si frymon jeta në disa momente:

"I lum për keshtjelin qi mbi kodra ngihej

⁷⁹ Milazim Krasniqi: *Soneti në poezinë shqipe*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005, fq. 102

*I palodhshëm viga përkundra anmikut:
Ku hovi i të huejvet porsi qelqe thehej.
O si shkulmat e detit në frymë të denikut”.*⁸⁰

Këto vargje sjellin atmosferën që mbizotëron në atdhe me këtë rast tregohet krenaria dhe përkushtimi ndaj atdheut, dhe njëkohësisht mposhtja e armiqve, që gjithnjë populli shqiptar i sheh si një pengesë e vazhdueshme qëndrimin e tyre në trojet shqiptare. Kur e lexojmë vetëm vargun e tretë të kësaj strofe atëherë do të njihemi me përkushtim të popullit dhe me mposhtjen e armikut në vazhdimësi. Kështu në këtë strofe jepet qartë porosia në mbrojtje të atdheut, ku dashuria për atdhe është më e madhe se vetë jeta e popullit, kështu që gjithnjë kjo porosi jepet gjatë kësaj strofe dhe në vazhdim të gjithë pjesës.

Pjesa e pestë e kësaj poeme të Mjedjes përbëhet prej elementit thirrës në mbrojtje atdheut. Me këtë rast kjo pjesë ka për synim që t'i thërret bijtë për t'i dalë në ndihmë atdheut.

Me faktin se përmendja e mbretit ilir Agronit, ka të bëjë se një thirrjeje e tillë për të dhënë kushtimin në mbrojtje të atdheut e ka zanafillën qysh në kohët e lashta. Kjo pjesë gjithmonë ndërlidhet me figurën e mbretit Agron si një prirës i luftës dhe vazhdues i palëkundur në mbrojtje të atdheut. Vargjet që pasojnë në vazhdim janë vargje që sjellin një thirrje të vazhdueshme në drejtim të popullit:

*“Ecni me heshta, ecni e me armë jetike,
Hov ' nju kualve me at mëni qi të parët
Ju mësoshin*

*Për lulëzimin e atdheut iu thurret Agroni!”*⁸¹

Vargjet që i cituam këtu janë vargje të një thirrjeje që duhet t'i përgjigjen të gjithë, pavarësisht kushteve dhe rrethanave të krijuara sepse një thirrjeje e tillë, gjithmonë, ka për qëllim që të mbrohet atdheu pavarësisht çmimit që duhet paguar, kështu që kjo thirrjeje e mbretit Agron, për mbrojtjen të atdheut, gjithnjë ka për qëllim që armiku të mos lejohet në shtrirjen dhe sundim të mëtejshëm në atdhe. Figura e mbretit Agron, në këtë pjesë është figura kryesore që bënë thirrjeje të vazhdueshme.

⁸⁰ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 132.

⁸¹ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 134.

Vargu i fundit i kësaj strofe mbanë gjithë intencën (qëllimin), e kësaj thirrjeje të vazhdueshme që bëhet nga Agroni, duke bërë këtë me qëllim të mobilizimit të popullit për t'u angazhuar, për t'i sjell popullit ditë më të mira në atdhe.

Ndërsa studiuesi Milazim Krasniqi, për figurën e mbretit Agron, thekson se: *një hare dhe një gëzim i përgjithshëm mbulonte jetën dhe botën ilire, ku poeti thur lavde për qytetin e Lezhës dhe thirrjen e mbretit Agron për lulëzim të atdheut.*⁸²

Në pjesën e gjashtë, ndryshon qasja e thirrjes, por gjithnjë duke pasur qëllimin e njëjtë në aspektin e thirrjes, sepse tashmë nuk kemi vetëm thirrje për mobilizim por tashmë ky mobilizim merr kahjen e një aktiviteti të vazhdueshëm nëpër kohë si në vargjet në vazhdim:

*“E kur fatosi n’patërshanë tui prekë,
Ç’detyrë, tha, kemi për atdhen, o burra?
Nji t’ilirve të gjegjunit: me dekë!”⁸³*

Vargjet e cituara këtu japin një porosi të qartë të popullit ndaj atdheut, dhe kështu njihemi me një përkushtim të vazhdueshëm të bijve shqiptarë ndaj atdheut, ku interesimi për t'i dalë në mbrojtje atdheut nuk mungon. Që në leximin e parë të kësaj pjese, njihemi me një përkushtim të vazhdueshëm të popullit që e bëjnë ndaj atdheut. Studiuesi Sabri Hamiti, kur flet për këtë pjesë të poemës këtë përkushtim të vazhdueshëm e përkufizon në këtë mënyrë: *ky identifikim poetik me një botë të krijuar në tekstin e vet, më tej vazhdon me adhurimin e kushtrimit për kundërvënie, të cilit i përgjigjen dhe i binden të gjithë njësoj bijtë e fisit, gra burra.*⁸⁴

Me këtë thirrje të vazhdueshme për të dalë në mbrojtje të atdheut, jepet një porosi e qartë se këtu në një formë jepet shenja se nuk ka tjetër përpos lirisë apo vdekjes dhe kështu një organizim i tillë qëndron fuqishëm në mbrojtje të atdheut. Pjesa e shtatë, paraqitet me një pamje tjetër, sepse derisa në pjesët paraprake kishim thirrje të vazhdueshme për të dalë në mbrojtje të atdheut, në këtë pjesë na shfaqet veprimi konkret do të thotë, këtu tashmë kemi pjesëmarrjen aktive në luftë, duke parë veprime konkrete të zhvillimit të luftës.

⁸² Milazim Krasniqi: *Soneti në poezinë shqipe*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005, fq. 103.

⁸³ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 135.

⁸⁴ Sabri Hamiti: *Letërsia filobiblike - letërsia romantike*, Faik Konica, Prishtinë, 2002, fq. 407.

Përballja e forcave ilire dhe atyre greke në këtë rast është një përballje, e cila gjithnjë ka për qëllim të shfaqë kushtrimin në mbrojtje të atdheut.

Në këtë pjesë flitet për një organizim mjaft të mirë që bëjnë forcat ilire kundër forcave greke, këtu jepen detaje të këtij organizimi që mund të themi se asgjë nuk i ndalon paraardhësit tonë ilirët. Vargjet e para të kësaj pjese japin një shenjë të një organizimi të mirëfilltë që ka të bëjë me luftën në vazhdim, dhe si organizim që ndoshta nuk kemi parë ndonjëherë, deri në këtë pjesë. Betejat e vazhdueshme që zhvillohen në këtë pjesë, do të njihemi me vargjet në vazhdim:

*“E vaj e ankime për gjith ani granija,
Kur ahte burrash e ulurime ushtoshin,
Nën thundrë të kualve tui i shtypë Shqypnija.”⁸⁵*

Vargjet e lartpërmendura e japin esencën e plotë të kësaj pjese, duke fuqizuar edhe më tej rolin e vet poeti, që e paraqet luftën në fjalë. Në këto vargje vërtet kemi të bëjmë me një betejë të ashpër të dy ushtrive që kanë misionë të ndryshme midis tyre, ilirët kanë për mision mbrojtjen, ndërsa grekët kanë për mision okupimin e trojeve tona. Këtu jo vetëm që jepet misioni i luftës, betejat, por dhe fitorja e ilirëve, duke triumfuar ndaj ushtrisë greke.

Vargu i fundit e jep simbolikën e një fitoreje të çmuar dhe shumë të rëndësishme të ilirëve, ku poeti gjithnjë e portretizon fitoren e ilireve në të gjitha betejat që jepen brenda pjesëve të kësaj poeme. Në këtë pjesë lufta dhe përballja e ilirëve dhe grekëve, paraqitet hapur ku gjithçka tashmë kemi konkrete gjatë përballjeve të vazhdueshme. Në pjesën e tetë të kësaj poeme mbizotëron vetëm lavdia dhe krenaria për të bëmat e popullit për atdhe, këtu thuren lavde nga më të ndryshmet duke bërë me dije se bijtë e atdheut gjithmonë ishin në gjendje gatishmërie, por njëkohësisht për këto veprime të tyre nuk munguan as thurjet e ndryshme të lëvdatave.

Kjo pjesë në tërësinë e saj ka për temë në vete thurjen e lavdisë, ku kjo temë e lavdisë kombëtare shprehet në mënyrë të veçantë, duke mos pasur tema të tjera si në pjesët e tjera, por gjithnjë lavdinë e të bëmave të bijve të kombit. Ky koncept i lavdisë kombëtare, portretizon një gjendje të re që tashmë është krijuar pas fitoreve në beteja, kështu bota

⁸⁵ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 136.

emocionale shpirtërore e subjektit lirik, përbën një gjendje në vete, ku gjithnjë i referohet fitoreve të vazhdueshme për të tejkaluar vuajtjet dhe sakrificat që kishim kaluar si popull në tërësi. Studiuesi Milazim Krasniqi, për këto tri pjesë gjashtë, shtatë dhe tetë, shprehet në këtë mënyrë: *Poeti e nuancon nisjet e ilirëve në luftëra, trimëritë e tyre dhe gatishmërinë për sakrifica, për të mbrojtur nderin e atdheut të vet.*⁸⁶

Nëse i referohemi edhe më tej këtij mendimi të lartpërmendur atëherë do të njihemi edhe më shumë me të kaluarën dhe të tashmen e popullit tonë, në këto tri pjesët e kësaj poeme gjithnjë jepen këto dy porosi lufta dhe fitorja. Në krahasim prej pjesëve të tjera, në pjesën e tetë tashmë flitet vetëm për fitore të ushtrisë shqiptare, si në vargjet në vazhdim:

*“Ktheni nder shpija, o djem, sokola
Ktheni
Me at dritë të shkëlqyeshme qi ju suell
Trimnija;
Krahas me ju vjen name e vjen luminija
Qi përhapun gjith shekullit ja keni.”⁸⁷*

Vargjet, të cilat i sollëm këtu në tërësinë e tyre mbajnë lavdinë për bijtë e atdheut, duke bërë që thirrja e popullit për kthimin e tyre në gjirinë e familjes të priten si heronj të vërtetë, që gjithnjë populli është i lumtur për ata bijë që i dolën në mbrojtje atdheut sa herë që ishte nevoja, dhe kështu gjithmonë kthimi i tyre në atdhe pritet me entuziazëm më të madh.

Që në vargun e parë dhe të tjerët në vazhdim thuren lavde trimërie në këtë pjesë, ku ndjenja e gëzimit dhe e krenarisë marrin karakterin e një gëzimi kombëtar, që do të vazhdojnë ditë më të mira në vazhdim, për t'ju kthyer gëzimi dhe lumturia tani e tutje popullit. Kurse vargjet në vazhdim të kësaj pjese vetëm sa e forcojnë mendimin dhe gjendjen emocionale që po mbretëron në shpirtin e popullit. Pjesa e nëntë, e poemës *Lissus* e Mjedjes, edhe një herë i kthehet historisë kombëtare, duke u thelluar në histori si një e kaluar mjaft e rëndësishme, ku qasja ndaj kësaj të kaluar kalon në një botë në vete, ku gjithçka frymon aq bukur dhe aq e rëndësishme, bëhet kjo e kaluar duke iu referuar figurave kryesore të historisë kombëtare, si prijësit më të rëndësishëm që janë nëpër kohë.

⁸⁶ Milazim Krasniqi: *Soneti në poezinë shqipe*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005, fq. 103.

⁸⁷ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 137.

Kthimi mbrapa në histori që është aq i theksuar në këtë pjesë të poemës *Lissus*, vazhdon me lavdinë dhe krenarinë kombëtare, ku figura e mbretëreshës Teutë, dhe e fisit ilir në përgjithësi, asocion me një të kaluar të lavdishme nëpër kohë. Këto figura të lashta historike që paraqiten në këtë pjesë nga ana e poetit, përbëjnë një element të rëndësishëm në vete duke parë se gjithmonë populli ynë ka pasur bijë trima. Edhe kjo pjesë njëjtë si pjesët e tjera, e fuqizon mbrojtjen e atdheut, por tashmë duke kaluar më larg në një periudhë tjetër historike, në atë të perandorisë romake që gjithnjë ka për qëllim mbrojtjen e atdheut.

Pjesa e dhjetë, e kësaj poeme lidhet kryesisht me qytetin historik të Lezhës, dhe me kryetrimin Skënderbeun, duke bërë që qyteti i Lezhës është njëri ndër qytetet historike, që përjetoj luftën dhe njëkohësisht privilegjin e një qyteti historik. Ky përshkrim i një lumturie të veçantë që do ta përjetojnë populli shqiptar pas fitores dhe pas krenarisë që tashmë kishin lënë gjurmë të pashlyera në kujtesën kombëtare. Vargjet e kësaj pjese në tërësinë e tyre projektojnë të ardhmen e popullit shqiptar, me një të ardhme të lavdishme dhe të suksesshme që tashmë duket se këto ditë kishin ardhur.

Madhështia dhe krenaria kombëtare, lidhet kryekëput me prezencën e varrit të Skënderbeut, por kjo madhështi ka një synim në vete se e kaluara e lavdishme e qytetit të Lezhës, asnjëherë nuk do të harrohet nga gjeneratat e reja. Vargjet që do të sjellim në vazhdim do të plotësojnë edhe më shumë një realitet të tillë.

*“Por se fatmadhe o Lezh një ditë do
Te mbërrinte
E ma të lumin nder shokë bota do ta thotë.
Kur në një kishë tande tempull të rij
Të përtrite
Se ti do të shifshe, o Lezh, kur të delte
Shtegut
Te një gjallnimit kreshnik e t'ulte shpatën
E ti vorrin do të mbajshe të Skënderbeut.”⁸⁸*

Vargjet e lartpërmendura të pjesës së dhjetë të kësaj poeme shprehin hapur motivin e ditëve më të mira që pritet të ndodhin, por dhe në këto vargje gjithnjë theksohet e kaluara

⁸⁸ Po aty, fq. 139.

dhe pritjet për ditë më të mira. Me idenë e ditëve të mira si edhe me hyjnizimin e të kaluarës paksa përsëritësh. Në fakt kjo është edhe detyra e romantikëve, ta lartësojnë popullin, ta paraqesin pa të meta.

Që në fillim të këtyre vargjeve shfaqet esenca e lavdisë kombëtare, ku në këtë pjesë hapur na shfaqet kjo lavdi, ku kemi të bëjmë me një porosi të veçantë që i drejtohet popullit nga ana e poetit për qytetin e Lezhës, ku mund të vijmë në një përfundim, se kemi të bëjmë se qyteti i Lezhës tashmë do të gëzojë një privilegj të veçantë prej gjeneratave të reja. Ky portretizim për qytetin e Lezhës, merr konotacionet e një qyteti që gjithmonë do të ketë privilegje të veçanta në krahasim me qytetet e tjera.

Pjesa e njëmbëdhjetë e kësaj poeme fillon me vargjet që ia numëron të bëmat e Skënderbeut, duke iu referuar gjithnjë trimërive të Skënderbeut. Në këtë pjesë të poemës kemi një përkushtim të veçantë që lidhet me aktivitetet e Skënderbeut, ku pikë referencës është aktiviteti i tij, për gjatë tërë luftës që u zhvillua dhe gjithnjë ky referim lidhet për një kohë të caktuar, pra për luftën, të cilën Skënderbeu ka qenë njeriu kryesor për, të cilin është i lidhur i gjithë ky portretizim nga poeti.

Kështu aktiviteti dhe përkrahja e vazhdueshme që gëzon gjatë luftës Skënderbeu nga shumë bashkëluftëtarë të tij, në këtë pjesë të poemës shfaqet lavdia dhe krenaria tashmë vetëm për kryetrimin e shqiptarëve, gjatë një periudhe mjaft të gjatë kohore që përjetuan i gjithë populli nëpër kohë.

*“Porsi j' lua mbas luftrave, kreshniku
U pshtet, molisun për atdhen e shgjeshi
Shpatën mnershme qi pat frikë anmiku,
E nam t'amshueshem Shqyptaris i reshi.”⁸⁹*

Vargjet që sollëm këtu japin një aktivitet mjaft të qartë të Skënderbeut, nëpër kohe që ky aktivitet gjithnjë është shfaqur nga poeti, si një aktivitet i jashtëzakonshëm që bëjnë bijtë e kombit për atdheun e vet.

Në këto vargje shfaqet esenca e gjithë kësaj pjese ku shfaqet trimëria dhe e kaluara e kryetrimin nëpër kohë, si një e kaluar e lavdishme, ku në të njëjtën kohë po ashtu edhe

⁸⁹ Po aty, fq. 140.

lumturia që ndjen kryetrimi për të bëmat e tij, që tashmë vendi gjendet në një kohë të mirë për të gjithë. Dashuria për kryetrimin dhe krenaria për të, bënë që poeti të thur vargje me një përkushtim dhe dashuri të veçantë, sepse në këto vargje kryetrimi na shfaqet si njeriu më meritor dhe më i rëndësishëm për ardhjen e këtyre ditëve.

Në këto vargje gjithnjë shfaqet një bashkërendim midis dy subjekteve popullit dhe kryetrimin, që ky bashkërendim në këtë rast ka një rëndësi të madhe, sepse as i pari dhe as i dyti nuk mund të kishin bërë atë që e arritën me bashkëpunimin midis tyre, dhe ky bashkëpunim ka bërë që të arrihet ajo që gjithmonë është ëndërruar nga të gjithë. Në vargjet e paraqitura këtu, janë vargje që mund t'i quajmë të një dashurie të veçantë që shfaqet për kryetrimin për të bëmat e tij dhe për këto ditë të lumtura që ia solli atdheut.

Pjesa e dymbëdhjetë e poemës *Lissus*, e Mjedës, është pjesa ku tërësisht poeti iu referohet lëndave pas vdekjes së Skënderbeut, duke kujtuar atë si një hero, i cili gjithmonë i solli mbrojtje dhe të mira atdheut. Kjo pjesë e poemës që njëherësh është dhe pjesa përmbyllëse e kësaj poeme, që bënë këtë përmbyllje në një mënyrë të veçantë për të shfaqur lavdinë dhe krenarinë e kryetrimin të shqiptarëve, pa ndonjë pa ndonjë zmadhim të tepruar për figurën e tij.

Dashuria për Skënderbeun, dhe lutjet që bëhen për të kanë një dashuri të pakufishme, që kjo dashuri simbolizon një dashuri të veçantë duke bërë që kryetrimi të mbetet ende i gjallë në mendjen e popullit. Këto lutje që bëhen për të kanë një zanafillë të kontributit të tij, që kishte dhënë për fenë dhe atdheun.

Pjesa e fundit e kësaj poeme kryesisht është e bërë prej lutjeve dhe dashurisë për Skënderbeun ku theksimi i shpeshtë i lutjeve në këtë pjesë vjen si një rezultat që përmbush dashurinë për të, në të njëjtën kohë kjo dashuri dhe lutjeje ka për qëllim shprehjen e fuqishme për bijtë e atdheut veçanërisht për Skënderbeun.

Ndërsa studiuesi Milazim Krasniqi për këto tri pjesët e fundit të kësaj poeme thekson: në tri njësitë e fundit të poemës afirmohet vlera e Lezhës si qytet mban ne gji varrin e kryetrimin Skënderbeut, i cili shërben nëpër shekuj si pikë referimi e nënave, që kërkojnë betimin e

djemve për besnikëri ndaj atdheut, akti i dhembshëm i ndarjes së kryetrimin nga të vetët dhe pikëllimi i ambientit hyjnor, ku poeti lutet që të gjejë prehje kryetrimi shqiptar.⁹⁰

Për ta përmbushur edhe më tej këtë mendim do të sjellim disa vargje të kësaj pjese të poemës:

“Ce dishmuesin, o Zot këndoshin qi

Jetën

Per shejten Fe, për Shyptarin e shkrini

E patundshme përherë shtyll e mbrojtje.⁹¹

3.3. Poema sonetike *Scodra* poemë mitike dhe historike

Kjo poeme sonetike përbëhet prej njëmbëdhjetë pjesëve, ku ndërtohet mbi bazën e dy motiveve kryesore që ka poema në vete, motive mitik dhe ai historik. Kjo poemë ka përafërsisht përbërjen sikurse poema paraprake *Lissus* për nga struktura dhe motivi, por gjithnjë duke u dalluar midis tyre. Në këtë poemë sonetike motivet e saj marrin një karakter ku përshkruhet një ngjarje mitiko historike në disa pjesë, që kanë një motiv të përbashkët këto pjesë, për të vazhduar në disa pjesë të tjera me motiv tjetër. Kjo poemë sonetike paraqet mitologjinë dhe historinë shqiptare ndër shekuj.

Poema fillon me motivin mitik në tri pjesët e para të saj, ku shfaqet një gjendje e popullit tonë nëpër kohë, qysh në lashtësi si një traditë e gjatë shekullore e popullit tonë në këto troje.

Pjesa e parë e poemës sonetike *Scodra* fillon me një thirrje sa mitike në drejtim të malit Tarabosh, po aq poetike, sepse e gjithë esenca e mitologjisë në këtë pjesë lidhet me malin e Taraboshit si një mal i lashtë që në këtë rast lidhet me besëtytnitë e lashta ilire si një vend i shenjtë ku gjithmonë ka pasur nën vëzhgim pjesët e tjera të vendit. Në këtë pjesë gjithnjë jepet esenca e një të kaluar të lashtë që këtu mali i Taraboshit merr kuptime mitike duke u paraqit si vend i veçantë dhe i rëndësishëm që gjithnjë populli si duket ka pasur një besim të veçantë në të.

⁹⁰ Milazim Krasniqi: *Soneti në poezinë shqipe*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005, fq. 103

⁹¹ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 141

*“E kuvendshe me të madhin e ilirit,
Ku t’lir si shqypet neper bjeshk, banoshin
Nipat e hyjevet ilirjak e t’robit.”⁹²*

Këto vargje kanë kuptimin e jetës, por njëkohësisht dhe shfaqja e bashkëbisedimit në mënyrë anonime midis udhëheqësit të ilirëve dhe sipas të gjitha konkluzioneve mali i Taraboshit, ka një mitologji në vete që gjithçka është e mundur sipas kësaj mitologjie të shfaqur këtu në këto vargje. Vargjet dy dhe tre, të kësaj strofe japin shenjën e një jete të lirë dhe të qetë në atdheun e tyre, kjo e dhënë për jetën e plotëson edhe më tej mitologjinë si një motiv që bënë pjesë në këto vargje dhe në këtë pjesë në tërësi.

Pjesa e dytë e poemës sonetike, po ashtu ka për motiv mitologjinë, por që në këtë pjesë vetëm sa fuqizon elementin mitologjik, duke dhënë edhe më tej kuptimin e lashtësisë së malit të Taraboshit, ku gjithnjë na paraqitet si një vend i rëndësishëm.

Këtu vetëm sa shtohet prezenca e Taraboshit nëpër kohë si një dëshmitar i vërtetë dhe i besueshëm që gjithçka kishte parë dhe dëgjuar për të kaluarën e vendit nëpër kohë, sipas kësaj mitologjie.

Në këtë pjesë kërkohet edhe më tej një dëshmi se në këto troje kanë qenë të pranishëm gjithmonë shqiptarët, dhe sipas kësaj dëshmitar më i denjë paraqitet mali i Taraboshit, që si duket ka parë shumë beteja që lidhen drejtpërdrejt për të ardhmen e atdheut.

*“O dishmitar i shekujve t’panjehun
Qi pershkovë me sy gjind e ndodhina
Si dhent blegtori kur avit te trina,
Vezhgon vathin e vet e rri tu i njehun”:⁹³*

Në këto vargje të kësaj pjese mali i Taraboshit ka rolin e një mbikëqyrësit ndër shekuj, por dhe aq të besueshëm te populli gjithnjë duke iu referuar elementit mitologjik që na paraqitet në këtë rast, si elementi kryesor që e përbën këtë strofë dhe të gjithë pjesën në vazhdim. Këto vargje faktorizojnë edhe më tej këtë mal, duke i dhënë epitete të ndryshme si ruajtës i vazhdueshëm i këtij populli.

⁹² Po aty, fq. 147

⁹³ Po aty, fq. 148.

Pjesa e tretë dhe e katërt e kësaj poeme sonetike, edhe më tej e rritë besimin në malin e Taraboshit, duke iu referuar të kaluarës, si një e kaluar e lavdishme nëpër shekuj. Pjesa e tretë paraqet bukuritë e ndryshme si bagëtinë dhe njëkohësisht dhe vendin e kufijve që këtu i referohet një shtrirje të tokave shqiptare, duke aluduar në një hapësirë të gjerë, rreth Krajës me rrethinë, por njëkohësisht kjo pjesë paraqet dhe pasurinë e popullit siç është blegtoria, si një faktor i rëndësishëm i ekonomive familjare shqiptare dhe kështu edhe kjo pjesë ka një karakter mjaft të rëndësishëm brenda poemës sonetike, sepse paraqet pasurinë e popullit.

Pjesa e katërt fillon me dëshminë e malit të Taraboshit, për një gjendje tjetër që ishte zhvilluar pra, me fillimin e zemërimit të perëndive greke, duke i sulmuar ato shqiptare në vazhdim. Kjo pjesë disi fillon ta shfaqë kundërshtimin dhe sulmin ndaj pjesa e katërt fillon me dëshminë e malit të Taraboshit, për një gjendje tjetër që popullit shqiptar. Tema mitologjike në këtë rast paraqet një kundërshtim të gjatë midis dy popujve, duke u përcaktuar si kundërshtarë të betuar midis vete, gjë që kjo shfaqet edhe në vazhdim.

Këtu jo vetëm që shfaqet zemërimi dhe kundërshtimi i perëndive greke ndaj perëndive ilire, por këtu poeti futet në lashtësinë e dy popujve duke i cilësuar si dy të lashtë, që nuk kanë dallime të mëdha midis tyre për nga lashtësia dhe mitologjia.

Pjesa e pestë, mund të themi se është një vazhdim i pjesës së katërt për nga motivi, ku edhe në këtë pjesë vazhdon zemërimi i perëndive greke, gjithnjë duke pasur për synim mposhtjen e perëndive ilire si kundërshtarë të përbetuar ndër shekuj. *Ky zemërim i tillë merr përmasat më të mëdha në këtë pjesë, duke u shfaqur edhe me veprime nga më të ndryshme në drejtim të perëndive ilire.*⁹⁴

Në këtë pjesë shfaqet veprimi i njëanshëm ku shfaqet vetëm sulmi i perëndive greke, që si duket ky veprim vetëm sa i nxit perënditë për një kundërpërgjigje në vazhdim.

Studiuesi Milazim Krasniqi, për zilinë e shfaqur thekson: *në pjesën më të madhe të poemës paraqitet zilia dhe përpjekjet e armiqve helenë për të shkatërruar atë begati e lumturi ilire.*⁹⁵

Kurse studiuesi Sabri Hamiti, për këtë poemë sonetike thekson: *nëse grekët kishin Olimpin, Mjedja këtë mal të shenjtë e sheh në Taraboshin. Apelacionet e tij janë të qarta dhe*

⁹⁴ Razi Brahimi, *Kritika*. Rilindja, Prishtinë, 1972.

⁹⁵ Milazim Krasniqi: *Soneti në poezinë shqipe*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005, fq. 105.

*mitizuese në të njëjtën kohë, gjithë poema zhvillohet në një ndërrim të vazhdueshëm të atmosferës hyjnore e mitike me atë të situatave reale, jetësore njerëzore.*⁹⁶

Pjesa e gjashtë dhe shtatë, hapin betejën e dy popujve ku hyjnorja dhe mitikja bashkohen për t'i dalë në ndihmë atdheut. Në pjesën e gjashtë shfaqet një kundërpërgjigje që do të bëjnë kundërshtarin ta ndjejë forcën e vërtetë ndaj tij, në këtë pjesë shfaqen figura hyjnore e si mbrojtëse të përhershme të atdheut, dhe duke iu bërë me dije armikut se këto troje janë shqiptare dhe askush nuk mund t'i marrë.

*“ E I farmakuem prej mnijet terfulloote
Si harusha për zogj, e një shit zgodhi
Non maje t'madhit Tarabosh e hodhi
Kundra bindit damtuer qi kobe l'shote.”⁹⁷*

Kur i referohemi edhe më tej kësaj pjesë të poemës sonetike, na shfaqet një mbrojtës i jashtëzakonshëm siç është figura të kundërshtari, për mbrojtjen e tokës shqiptare. Me këtë pjesë kthehet ngritja e bijve të atdheut, ku pastaj shfaqen dhe veprimet e paraardhësve tonë. Në këtë pjesë gjithnjë rol të rëndësishëm kanë figurat mitike shqiptare.

Pjesa e shtatë është vazhdim i pjesës së gjashtë në të cilën konflikti mitik vetëm sa vazhdon edhe më tej duke u shfaqur konflikti i një beteje të zhvilluar midis dy vendesh. Në pjesa e shtatë zgjerohet beteja dhe konflikti në vazhdim si dy fronte që zhvillohen mjaft hapur, ku shfaqja dhe dominimi i hyjnive shqiptare siç është rasti i Axilemit dhe Kulshedrës, që njëherësh midis këtyre shfaqet gjithë simbolika e kundërshtimeve në beteja dhe kërkesa e brendshme për dominim, është një pjesë ku shfaq hapur dëshirën për dominim të të dy palëve.

Në këtë rast është një shfaqje poetike për dominimin e e hyjnive mitike shqiptare, ndaj atyre greke ku në mënyrë poetike poeti, e sajton situatën dhe betejën në mbrojtje dhe përkrahjeje të hyjnive shqiptare, që dyluftimi i këtyre hyjnive e mbanë simbolikën e dy popujve në vazhdimësi.

⁹⁶ Sabri Hamiti: *Letërsia filobiblike - letërsia romantike*, Faik Konica, Prishtinë, 2002, fq. 408.

⁹⁷ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 153.

Pjesët tetë dhe nëntë, të kësaj poeme sonetike, hapin një pamje tjetër, ku tashmë nuk shfaqen betejat apo konflikti, por atmosfera e sjellë në këto pjesë që fillon në të tetën dhe vazhdon në të nëntën, bënë një thirrje për një festim të fitoreve, ku lumturia dhe gëzimi i popullit nga të gjitha anët nuk mbaron.

Në pjesën e tetë, jepet pamja e një gëzimi të jashtëzakonshëm për fitoren e arritur, duke u mbledhur të gjithë banorët e rrethit të Shkodrës, për të festuar me këngë në mënyra të ndryshme, sepse këto ditë ishin pritur me mund dhe sakrificë, por duhet të mos harrojmë se edhe në këtë pjesë është i pranishëm elementi mitik si një vazhdues në të gjitha pjesët.

*“E thirrte Kodri O djelmëni kreshnike,
Me dhen gur e permend leni n'bungaje
Spatat e ngulme leni tok' t fisnike
E leni beret qi kullosni n' zaje.”⁹⁸*

Kjo strofë në tërësinë e saj është një strofë thirrëse, e popullit për t'i lënë të gjitha në një anë vetëm e vetëm për t'u bashkuar festës së popullit, ku gjithçka tashmë merr karakterin e një atmosfere festive për nder të arritjes së lirisë së vendit. Fusha e veprimit dhe atmosfera festive që paraqitet në këtë pjesë vjen si rezultat i fitores të hyjnive mitike ku gjithnjë jepet një kontribut i madh i tyre për atdheun.

Kurse pjesa e nëntë e poemës është vazhduese e pjesës paraprake, ku edhe në këtë pjesë përcillet atmosfera festive, duke u mbledhur gjithë banorët e Shkodrës, me rrethinë për të shijuar atmosferën e lirisë, që tashmë ishte bërë realitet.

*“E kndoshin çetat tui zbrit, e ushtoshin
Fush e lugje t'gjelbrume e shena e prroje
N'brohoritjet t'ushtris kur n' pun
U Ishoshin.”⁹⁹*

Këto vargje sjellin atmosferën, e cila është krijuar pas fitores dhe festa tashmë merr një kahje të gjerë në përkrahje të fitores, si nga ushtria që është një mbrojtëse e vazhdueshme e vendit, po ashtu dhe populli është vënë në manifestim të gjerë. Kështu që në këtë rast

⁹⁸ Po aty, fq. 155.

⁹⁹ Po aty, fq. 156.

populli ndihet tashmë i lirë dhe me të drejtë për të festuar, ku lumturia dhe liria e popullit ndjehet në tërë vendin.

Pjesa dhjetë dhe njëmbëdhjetë janë pjesët ku paraqitet qetësia dhe ulja e hyjnive rreth fronit. Në pjesën e dhjetë na shfaqet një qetësi ku kërkohen të ulen të gjithë, dhe të vazhdojnë jetën të qetë në Iliri dhe t'iu binden urdhrave të hyjit të detit Poseidonit, sepse tashmë kërkohet një qetësi dhe maturi, ku duhet të veprohet në bazë të një hierarkie, sepse asgjë nuk bëhet pa urdhër të hyjnive. Pjesa e dhjetë është pjesa më e qetë për nga ana e tensioneve dhe konflikteve, sepse këtë pjesë nuk kemi as konflikt as kundërshtime midis perëndive shqiptare dhe greke.

Pjesa e njëmbëdhjetë e poemës sonetike Scodra e Mjedës, në strukturën e saj shfaq një moment të rëndësishëm ku hapet çështja e pajtimit midis hyjnive shqiptare dhe greke duke krijuar një situatë krejt tjetër tashmë, sepse pretendohet se janë kaluar ato inatet dhe armiqësitë e ardhura në një moment që kërkohet deri më tani, duke ardhur në një moment që kërkohet pajtim i të dy palëve të hyjnive.

3.4. Poema sonetike *Lirija* thirrje për lirinë e atdheut

Poema sonetike *Lirija*, në konceptin e figuracionit poetik që e mban në vete, është poemë sonetike, e thirrjes lirisë së atdheut, duke pasur parasysh se në këtë poemë na shfaqen një mori figurash duke filluar prej pasthirmës, metaforës, hiperbolës etj. Pjesa e parë e kësaj poeme është e përbërë prej figurës së pasthirmës, si njëra ndër figurat kryesore në këtë pjesë, duke pasur parasysh se gjithçka lidhet me një pasthirmë poetike përmes kësaj figure që të ngritet populli dhe të kërkojë liri.

Figura e pasthirmës është e pranishme në këtë pjesë si njëra ndër figurat kryesore ku paraqitet vargun:

“O shqype, o zogjët e malevet, kallxoni”¹⁰⁰

Në këtë varg figura e pasthirmës lidhet ngushtë me një kërkesë të subjektit lirik që gjithnjë dëshiron të dijë më tepër për atdheun.

¹⁰⁰ Po aty, fq. 121.

Pjesa e dytë ka qëllim që ta thërras popullin në mbrojtje të atdheut. Këtu figura e pasthirmës realizon një mision që duhet të kryhet, ku në të njëjtën kohë kjo thirrje delikate e subjektit lirik gjithnjë i shtohen edhe faktorë tjerë siç është rasti i shteteve si Amerika dhe Anglia që tashmë kjo pjesë jo vetëm që është thirrje për atdhe, por dhe një argument më tepër për ta mbrojtur atdheun. Figura e këtyre dy shteteve është një argument i fuqishëm që e përdor poeti, në kuadër të thirrjeve të vazhdueshme.

Pjesa e tretë dhe e katërt, përbëhen prej figurës së hiperbolës si figura dominante në këto dy pjesë duke sjell një atmosferë tjetër, duke krijuar nder dhe lavdi për këto dy shtete që i dhanë një përkrahje popullit shqiptar, gjithnjë por e gjithë esenca e kësaj figure, lidhet me lavdinë që iu jepet këtyre shteteve që kishin dhënë një kontribut për popullin shqiptar.

Figura e hiperbolës në këtë rast krijon një gjendje tjetër emocionale te subjekti lirik në këto pjesë, duke bërë që hiperbolizimi të shfaqen dy gjendje emocionale: e para subjekti lirik shfaq shenja gëzimi në vete dhe e dyta lavdia e krijuar tashmë zënë një vend të rëndësishëm në këto dy pjesë të poemës sonetike *Lirija të Mjedës*.

Të lumtë, o Washington! U shvillat

Qielli,

U njom toka për mall me brohorië

E mbi flamuj të zotnuem ndejti luani.¹⁰¹

Ky varg dhe vargjet në vazhdim janë vargje ku na shfaqet kjo figurë si njëra ndër figurat dominante brenda kësaj pjese, duke thur lavde dhe krenari për përkrahësit e popullit dhe njëkohësisht një falënderim i veçantë për këto ditë të lumtura që ia kishin sjell atdheut, dhe me këtë rast kjo figurë e fuqizon edhe më tej rolin e përkrahësve në aspektin e çështjes kombëtare.

Në pjesën e pestë, të kësaj poeme sonetike na shfaqet një deklaram poetik, i cili pasqyron një gjendje të nënshtrimit të popullit para armikut, kështu e gjithë pjesa e pestë e ka këtë deklaram të mbuluar me figurën e litotës (zvogëlimit), si shenjë e një gjendje të rëndë shoqërore, duke deklaruar në mënyrë të hapur realitetin që është krijuar.

¹⁰¹ Po aty, fq. 123

Vetëm kur i referohemi strofës së parë, të kësaj pjese shohim se kemi të bëjmë me një nënshtrim të jashtë mase që i bëhet popullit, ku figura e litotës e jep këtë gjendjeje në mënyrë më të mirë, sepse gjendja e rëndë politiko - shoqërore që është krijuar poeti e jep përmes vargjeve të tij si deklarues i një realiteti.

Pjesa e gjashtë, e kësaj poeme sonetike konceptohet përmes figurës së krahasimit që do të thotë se këtu liria dhe robëria janë dy gjendje shpirtërore të popullit, duke pasur parasysh se kjo pjesë fillon me vargun deklarativ në aspektin e mbrojtjes së lirisë së atdheut, si një përkushtim i vazhdueshëm i popullit ndaj atdheut. *Këtu në këtë pjesë figura e krahasimit vë në ballë lirinë dhe robërinë, por ajo se çka deklarohet në vargjet dhe strofat në vazhdim padyshim se liria si triumfuese ndaj robërisë, ku gjithnjë në këtë pjesë përhapet liria, me të gjitha karakteristikat e saj, duke përshkruar vendin me të kaluarën e tij.*¹⁰²

3.5. Figura e hiperbolës në poemën sonetike *Lissus*

Kjo poemë sonetike karakterizon një gjendje shoqërore, duke paraqitur një realitet por gjithnjë sipas figurës së hiperbolës si njëra ndër figurat dominante në këtë poemë. Kjo poemë sonetike fuqizon gjendjen nëpër të cilën kalon populli. Në tri pjesët e para të kësaj poeme paraqitet bukuria e vendit, duke i përshkruar këto bukuri me disa epitete që janë karakteristik e përdorimit nga ana e poetit, ku në këto pjesë jepet bukuria natyrore e vendit dhe traditave tona.

Përshkrimi i bukurive dhe traditës sonë të lashtë i karakterizojnë këto tri pjesë si një gjendjeje e cila ka mbretëruar gjithmonë. Figurat dhe epitetet të përdorura në këtë tri pjesë funksionalizojnë një gjendje mjaft të rëndësishme, duke pasur parasysh se në këto tri pjesë paraqiten dy faktorë të rëndësishëm të vendit, do të thotë bukuria e vendit dhe tradita e lashtë.

*“Nëpër kodra të stolisuna me vneshta
Kur vilet ari xhinxhillojshin në dielli
E, rrotull fushën tui kaditun prilli*

¹⁰² Qendra e studimeve albanologjike, Qendra Muzeore “Ndre Mjeda”. “Mjedologji”. Gjergj Fishta, Lezhë, 2014.

*Edhe lulzote te kur kish himun vjeshta:*¹⁰³

Këto vargje japin epitetin e bukurive natyrore shqiptare si një ndër bukuritë e rralla që e karakterizojnë ambientin tonë shqiptar, ku përshkruhet gjithçka me bukuritë e saj, që njëherësh kjo poemë shfaq një karakteristikë të vendit tonë, si një vend me bukuri që i përshkruan poeti.

3.6. Qyteti i Shkodrës si toponim dhe figurë në poemën *Scodra*

*Në vitin 1939- Scodra botohet në rev. Kumbona e së diellës. Ajo është poemë e papërfunduar. Aty shkrihet erudicioni i tij historik dhe mitologjik. Ka patur mendime për Scodrën, se ajo u shkrua nën ndikimin Horacian e Karducci-an.*¹⁰⁴

Poema sonetike *Scodra* është njëra ndër tri poemat sonetike të Mjedjes, që ka një figuracion dhe toponim real në poemë. Kjo poemë fillon dhe mbaron, duke pasur në qendër të diskutimit poetik qytetin e Shkodrës si toponim shqiptar, këtu figuracioni për këtë qytet përbën tërësinë e poemës në fjalë. Në katër pjesët e para, të kësaj poeme na shfaqet figura e pasthirmës si njëra ndër figurat kryesore që i përmban këto pjesë, duke pasur parasysh se me këtë figurë paraqitet gjithë aktiviteti i subjektit lirik.

*Kjo figurë, e cila është e pranishme në këtë pjesë paraqet funksionin e toponimit të malit Tarabosh, që ky mal në këtë poemë ka funksionin e toponimit që i gjithë aktiviteti dhe përgjegjësia bie mbi të si toponim kryesor në këtë poemë.*¹⁰⁵

*“Difto si grigjen nëpër shpat kur l'shote
Me l'kur' harushet vesh e njesh barija,
Gjithë rrotull Krajës. E kah e merr Rumija
Kumbim trokash mbi troje tingullote;”*¹⁰⁶

¹⁰³ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 129.

¹⁰⁴ Ruzhdi Ushaku. *Mbi motivet onomastike në poemthin “Scodra” të Ndre Mjedës*, në rev.: Malësia, Podgoricë, Shoqata për kulturë dhe çështje shoqërore “Malësia”, 2008, f. 53-63

¹⁰⁵ Rinush Idriji, *Ndre Mjedja*. Tiranë, 1980.

¹⁰⁶ Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 150.

Këto vargje janë dëshmi e figuracionit të ngjeshur, duke pasur parasysh se këtu mund të gjejmë figurën e epitetit, toponimit etj., këto vargje gjithnjë janë të ndërtuara mbi figurën e pasthirmës, por që në këtë rast figurat e tjera vetëm sa e plotësojnë figurën e pasthirmës.

Këto katër pjesët e kësaj poemës sonetike, krijojnë një koncept të fuqishëm mbi rëndësinë dhe lashtësinë e malit Taraboshit, duke i dhënë këtij mali një funksion të madh brenda kësaj poeme në tërësi. Toponimi i malit të Taraboshit dhe figura e pasthirmës në këto pjesë luajnë dy role mjaft të mëdha në katër pjesët, roli i parë është se toponimi malit Tarabosh e ka simbolikën e tij si mal mitik, dhe rolin e dytë është se këto pjesë janë mbushur me figurën e pasthirmës, ku subjekti lirik i drejtohet malit në fjalë, përmes kësaj figure.

Pjesa e pestë dhe gjashtë, shtatë dhe tetë, të poemës sonetike na shfaqet figura e alegorisë, me emërtimet mitike që kanë disa subjekte lirike siç është rasti me emrin e kulshedrës dhe të Polifemit etj., që karakterizon këto pjesë, duke iu dhënë një kuptim të qartë përmes alegorisë, ku kjo figurë përshkruan një realitet të përjetuar nga populli ynë.

“E një njegull nder male, e jer qelbsinet

Ej vap e mnershme per gjith vend

Shperndahej

Ku nder lugje ma t'rita e n'pod rudinet

Me t'përjetshmen sherbel gjineshtra

Thahej”¹⁰⁷

Në këto pjesë përmes alegorisë fuqizohet gjendja e robërisë si një gjendje e rëndë që e përjeton populli.

Alegoria për luftën dhe heroizmin e bijve shqiptarë fuqizon aktivitetin dhe dashurinë dhe dashurinë për atdhe të të gjithë bijve shqiptarë. Pjesët nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë janë pjesë në të cilat më shumë jepet peizazhi i vendit që ndërlidhet me një përshkrim të vendeve dhe njëkohësisht figurat mitike që e karakterizojnë këto pjesë, bëjnë që në këto pjesë të jepet një porosi për qetësi të vazhdueshme, sepse në këto pjesë figurat mitike shqiptare dhe greke janë në një gjendje të qetësisë kur figurat mitike greke dhe ato shqiptare janë pranë një pajtimi.

¹⁰⁷ Po aty, fq. 152.

Këto pjesë janë të përbëra drejtpërdrejt prej të dy taborresh perëndish, ku na shfaqet hapur dëshira për pushtet edhe në vazhdim, perënditë shqiptare dhe ato greke, janë figura mitike që përfaqësojnë këto pjesë.

*“Gjimoj moti ne e rrmakt e zane t'mbulueme
Shungullueme prej s ' neltit t'nji dritores;
Afërdita për fli Rozafën ly”¹⁰⁸*

Në këto vargje paraqitet gjendja për të cilën kërkohet një pajtim, përsëri figura e Afërditës dhe Rozafës na shfaqen si figura mitike që përfaqësojnë dy popuj shqiptarë dhe grekë.

¹⁰⁸ Po aty, fq. 159.

Përfundim

Gjatë këtij punimi kam bërë një përzgjedhje të formës së punimit, duke u përcaktuar në dy rrafshë të studimit të poezisë së Ndre Mjedjes, ku japim një skemë të punimit që kjo skemë bëhet metodë e punë sonë në këtë punim.

Në këtë punim mbi poezinë e Mjedjes, sjellim një aspekt të studimit mbi figuracionin dhe semantikën e poezisë që njëherësh kjo mënyrë e studimit në këtë punim arrin të japë disa përfundime, që janë rezultat i punës që kam bërë në këtë punim.

Ky punim me titull Figuracioni në poezinë e Ndre Mjedjes, ka në vete tre kapituj që njëherësh është edhe struktura e punimit, që pasqyron punën time rreth studimit të poezisë së Mjedjes. Ky punim me këtë ndarje në kapituj paraqet disa aspekte të poezisë së Mjedjes, ku kapitulli i parë ka të bëjë më shumë me romantizmin si formacion letrar dhe me poezinë e Mjedjes, për të vazhduar me qëllimet e këtij formacioni dhe poezisë së Mjedjes, që njëherësh ky kapitull paraqet synimet e studimit të poezisë së Mjedjes.

Kapitulli i dytë në këtë punim parashtron studimin më të gjerë mbi poezinë e Mjedjes, që njëherësh në këtë kapitull fillojmë me studimin e poezisë në mënyrë të detajuar, pra bëjmë një studim semantik dhe semiotik mbi poezinë duke sjellë dy rrafshë të studimit mbi poemën Andrra e jetës, poemthave të tjera dhe disa poezive, dhe synojmë të plotësojmë këtë aspekt të studimit, gjithmonë duke nën përmasat e temës së përcaktuar.

Në kapitullin e tretë kemi të paraqitur, mbi poemat sonetike të Mjedjes, duke i analizuar këto poema në bazë të kriterit në fjalë, që gjithmonë kemi parasysh, këtu metodën e studimit për të cilën jemi përcaktuar.

Bibliografia

1. Alfred Uci, *Probleme të estetikës*. Rilindja, Prishtinë, 1980.
2. Ali Aliu: *Teoria e letërsisë* - Doracak për nxënësit e arsimit të mesëm, Rilindja, Prishtinë, 1986.
3. Ali Aliu: *Teoria e letërsisë* - doracak për nxënësit e arsimit të mesëm, Rilindja, Prishtinë, 1986.
4. Anton Nikë Berisha, *Ndrë Mjeda "Ëndrra e jetës", "Shpresa"*, Prishtinë, 2005.
5. Behar Gjoka. *Botëperceptimi poetik i Mjedës në poemën Andrra e jetës*, në: Mehr Licht! nr. 25. Tiranë, Ideart, 2005, f. 368-374
6. Edlira Macaj (Tonuzi). *Poetika e Mjedjes dhe Shkolla Jezuite*: Disertacion. Tiranë, 2015.
7. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, *Historia e letërsisë shqipe I-II*. Botimi i tretë, Prishtinë, 1975.
8. Flamur Maloku. *Vaji i Bylbylit, figura në relacion me kodin tematik në gaz.*: Tema, dt. 12.04.2009
9. Jorge Luis Borges: *Kjo mjeshtri e poezisë*, përktheu: Arsim Canolli, Ceneus, Prishtinë, 2010.
10. Kolec Topalli, *Ndre Mjeda si gjuhëtar*, (Konferencë Shkencore, Ndre Mjedja 150 vjetori i lindjes), „ASHAK”, Prishtinë, 2016.
11. KultPlus. *Ndre Mjeda, intelektual i që ia kushtoi jetën Shqipërisë*. 11 Gusht, 2020. Marrë në: <https://www.kultplus.com/tag/ndre-mjeda/>
12. Latif Sermaxhaj, *Poetika e Ndre Mjedjes*. Asdreni, Shkup, 2010.
13. Mark Gurakuqi, *Arti i Mjedës, Vëzhgime kritike*. Prishtinë, 1978.
14. Mark Gurakuqi, *Mbi veprën poetike të Mjedës*. Tiranë, Naim Frashëri, 1980.
15. Mentor Quku, *Mjeda 1-8, Ilar*. Tiranë, 2004-2010.
16. Milazim Krasniqi: *Soneti në poezinë shqipe*. PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005.
17. Ndre Mjedja: *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

18. Ndriçim Kulla, *Poetë të mëdhenj në letërsinë dhe historinë shqiptare*. Plejad, Tiranë, 2006.
19. Pashko Gjeçi. *Ndre Mjedja, Juvenilja*, në *Kritika* nr. 1, mars 1944
20. Qendra e studimeve albanologjike, Qendra Muzeore “Ndre Mjeda”. “Mjedologji”. Gjergj Fishta, Lezhë, 2014.
21. Razi Brahimi, *Kritika*. Rilindja, Prishtinë, 1972.
22. Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I*. Rilindja, Prishtinë, 1986.
23. Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi III*. Tiranë, 2000.
24. Rifat Ismaili, *Historia e letërsisë shqipe II*. Prishtinë, 2000.
25. Rinush Idrizi. *Ndre Mjedja*. Tiranë, 8 nëntori, 1980
26. Ruzhdi Ushaku. *Mbi motivet onomastike në poemthin “Scodra” të Ndre Mjedës*, në rev.: Malësia, Podgoricë, Shoqata për kulturë dhe çështje shoqërore “Malësia”, 2008, f. 53-63
27. Sabri Hamiti, *Ndre Mjedja*. Faik Konica, Prishtinë 2016.
28. Sabri Hamiti, *Studime letrare*. Prishtinë, 2003.
29. Sabri Hamiti: *Letërsia filobiblike - letërsia romantike*, Faik Konica, Prishtinë, 2002.
30. Zejnullah Rrahmani, *Arti i poezisë*. Faik Konica, Prishtinë, 2001.

Unë, Elhame Arifi, me profesion Lektore, nën përgjegjësi morale dhe materiale, më datë 15.02.2021, jap këtë:

DEKLARATË

Me të cilën deklaroj se kam lektuar temën me titull: "Figuracioni në poezinë e Ndre Mjedjes", të kandidatës Syzanë Shaqiri.

Prishtinë, 15.02.2021

LEKTORE
EMRI DHE MBIEMRI
Elhame Arifi

NËNSHKRIMI




Nr. telefonit: 045 379 365

E-mail adresa: lekturim@hotmail.com